# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5912
E enjte, 24 tetor 2019
çmimi 0.40 €


## Kongresi Amerikan miraton rezolutën për ndriçimin e vrasjes së vëllezërve Bytyçi

FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", BLERIM REKA FAQE 4-5

# ShBA-ja të ndërmjetësojë në dialogun midis dy shteteve Kosovë - Serbi



- Historia tash e një shekull kohë ka treguar se pa amerikanët nuk mbyllet asnjë problem në Ballkan. As ky midis Kosovës dhe Serbisë

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka vlerësuar se moshapja e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut është vendim i gabuar i Bashkimit Evropian. Ai ka thënë se është gabim strategjik mbetja e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor jashtë orbitës së BE-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Reka ka deklaruar se presidenti Macron pretendon të bëhet lideri evropian pas pensionimit të Merkelit dhe pas daljes së Britanisë nga BE-ja. Ai ka thënë se ka ardhur koha që ShBA-ja ta ndërmjetësojë dialogun midis dy shteteve Kosovë - Serbi. Reka ka theksuar se amerikanët u rikthyen në Ballkan kur e panë paaftësinë dhe dështimin e BE-së për ta ndërmjetësuar dialogun

## A do të mund të zvogëlohet numri i ministrive në 12 sosh?

Synimin e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), që qeveria e re t'i ketë vetëm 12 ministri, e shohin të pamundshëm njohësit e proceseve politike në vend. Analisti politik Naim Rashiti ka thënë se LV-ja dhe LDK-ja mund ta zvogëlojnë numrin e ministrive, por nuk ka logjikë të mbesin vetëm 12 ministri. Kurse koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, i cili ka punuar në hartimin e projektligjit për qeverinë, ka thënë se numri i ministrive nuk duhet të jetë më i madh se 15 sosh FAQE 3





## KQZ-ja: Nuk ekziston rrezik për zarfet e mbetura që erdhën nga Serbia

FAQE 7

## AKTUALE



PRESIDENTI THAÇI DEKOROI MIQTË JAPONEZË QË PROMOVUAN KOSOVËN F. 7

POLICIA FILLON EDHE KONTROLLET TEKNIKE TË VETURAVE F. 6

INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT ANËTARËSOHET ME TË DREJTA TË PLOTA NË EQUINET F. 3

## EKONOMI

HAPET PANAIRI NDËRKOMBËTAR 'AGROKOS', MARRIN PJESË MBI 100 KOMPANI F. 9

PËR 125 ASETE AKP-JA PRANON 79 OFERTUES F. 9

## KULTURË

ZYRTARJA E AMBASADËS AMERIKANE VIZITON BIBLIOTEKËN E QYTETIT NË MALISHEVË F. 10



## SPORT

DITË E VENDËSVE NË SUPERLIGË F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Kongresi Amerikan miraton rezolutën për ndriçimin e vrasjes së vëllezërve Bytyçi

Dhoma e Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) ka miratuar rezolutë për ndriçimin e vrasjes së vëllezërve Bytyçi. Përmes kësaj rezolute i kërkohet Serbisë që t'i vë para drejtësisë vrasësit e tre vëllezërve Bytyçi, shtetas amerikanë, në vitin 1999, ndërsa bën thirrje që përparimi për ndriçimin e këtij rasti të jetë "faktor i rëndësishëm që përcakton zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Serbisë"



**Uashington, 23 tetor** - Dhoma e Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara ka miratuar një rezolutë, me të cilën i kërkohet Serbisë që t'i vë para drejtësisë vrasësit e tre vëllezërve Bytyçi, shtetas amerikanë, në vitin 1999, ndërsa bën thirrje që përparimi për ndriçimin e këtij rasti të jetë "faktor i rëndësishëm që përcakton zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Serbisë".

Kryetari i Komisionit të Dhomës së Përfaqësuesve për Marrëdhëniet me Jashtë, Eliot Engel, ka thënë se kjo çështje ishte e rëndësishme për të, duke pasur parasysh lidhjet me komunitetin shqiptar dhe se ai e njeh personalisht familjen e vëllezërve, Ylli, Agron dhe Mehmet Bytyçi.

Engel ka pohuar se ai e di që autoritetet serbe kanë njohuri se kush janë personat përgjegjës. "Nëse Serbia do që të bashkohet me perëndimin, ajo duhet të përballet me të shkuarën dhe pranojë përgjegjësinë", ka thënë ai.

Ligjvënësi nga Nju Jorku, Lee Zeldin, ka pohuar se kjo çështje është ngritur vazhdimisht me autoritetet serbe. "Dua t'i them Serbisë se ky është një mësim i rëndësishëm, se pas 20 vjetësh ne (Shtetet e Bashkuara) nuk kemi harruar dhe nuk do të harrojmë kurrë. Ne do të këmbëngulim që drejtësia të vihet në vend".

Menjëherë pas miratimit, reagoi vëllai i Ylli, Agron dhe Mehmet Bytyçit, Ilir Bytyçi, duke shprehur vlerësimin e familjes së tij për rezolutën: "Shpresojmë që i Dërguari i Posaçëm, Matt Palmer dhe i Dërguari i Posaçëm Rich Grenell t'i dëgjojnë këto zëra dhe ta bëjnë përparësi çështjen e vëllezërve Bytyçi dhe drejtësinë për krimet e luftës në punën e tyre. Sot Kongresi tregoi se viktimat nuk mund të injorohen".

Rezoluta ishte miratuar në korrik të këtij viti nga Komisioni për Marrëdhënie me Jashtë i Dhomës së Përfaqësuesve, vetëm pak ditë pas përvjetorit të vrasjes së vëllezërve Bytyçi. Ajo ishte hartuar nga ligjvënësit Eliot Engel dhe Lee Zeldin.

Ylli, Agron dhe Mehmet Bytyçi, ishin pjesëtarë të ish Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përkatësisht të batalionit Atlantiku, i përbërë nga shqiptarë që jetonin në Shtetet e Bashkuara, e të cilët ju bashkuan luftës në Kosovë.

Në muajin korrik të vitit 1999 ata ishin arrestuar në rrethana të panjohura nga forcat serbe në afërsi të vendkalimit kufitar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Merdarë.

Një gjykatë në qytetin e Prokuples në Serbi, i kishte dënuar me nga 15 ditë heqje lirie nën akuzat për siç është thënë, kalim të paligjshëm të kufirit të ish-Jugosllavisë.

Trupat tyre u gjetën në një varrezë masive në Petrovo Selo në Serbinë lindore, në një bazë të kontrolluar nga njësitë që komandoheshin nga ish gjenerali i policisë serbe, Goran Radosavleviç, i njohur si Guri. Ata ishin me duar të lidhura dhe ishin qëlluar në kokë.

Në Rezolutën e miratuar të martën thuhet se "Shtetet e Bashkuara duhet t'iu kushtojnë vëmendje përpjekjeve të qeverisë së Serbisë dhe ministrave të saj përkatës, si dhe zyrtarëve të tjerë, të cilët po ndërmarrin hapa për të hetuar dhe ndjekur penalisht personat që besohet se janë përgjegjës për vrasjen e vëllezërve Bytyçi. Përparimi në zgjidhjen e këtij rasti, ose mungesa e vullnetit, duhet të jenë faktor i rëndësishëm në përcaktimin e zhvillimit të ardhshëm të marrëdhënieve ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Serbisë", thuhet mes tjerash në dokument.

Rezoluta u referohet fakteve rreth vrasjes bashkë me përfshirjen e ish-zëvendës-ministrit të Brendshëm të Serbisë, Vlastimir Gjorgjeviç dhe Goran Radosavleviçit. Ajo përfshinë edhe premtimet e papërmbushura të presidentit serb, Aleksandër Vuçiq. Që nga viti 2006 janë zhvilluar dy procese gjyqësore në lidhje me rastin e vëllezërve Bytyçi ndaj dy ish-policëve serbë, të cilët më pas janë lënë të lirë.

Zhvillimi i proceseve u përcoll me shumë reagime të veprimtarëve humanitarë të cilët janë shprehur të pakënaqur me mënyrën e trajtimit të çështjes.

## Thaçi mirëpret miratimin e rezolutës "Bytyqi" nga Senati i ShBA-së

"E mirëpres miratimin e rezolutës "Bytyqi" nga Senati i ShBA-së, që shpreh pakënaqësi me vonesat që po bën Serbia në dënimin e fajtorëve për vrasjen e vëllezërve Bytyqi nga aparati shtetëror serb në vitin 1999", ka shkruar presidenti Hashim Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se kjo rezolutë mundëson që të shtyhet përpara çështja në instancat më të larta të ShBA-së, por gjithashtu sipas tij, tregon se kur është në pyetje Kosova, ShBA-ja është një, pa dallime partiake.

"Për ne është inkurajim që të vazhdojmë të kërkojmë drejtësi për të gjitha viktimat e regjimit serb në Kosovë dhe se drejtësia për vëllezërit Bytyqi më në fund do të vihet në vend", ka shkruar Thaçi.

Edhe kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se miratimi në mënyrë unanime i rezolutës për vëllezërit Bytyqi, nga Kongresi Amerikan, është një lajm i mirë, jo vetëm për këtë familje por edhe për dëshmimin e krimeve të pushtetit serb, të kryera në Kosovë.

## Zbulohet një celulë terroriste në Shqipëri

**Tiranë, 23 tetor** - Policia e Shqipërisë tha të mërkurën se ka penguar një sulm të planifikuar nga një "qelizë terroriste", e mbështetur nga Teherani, kundër kundërshtarëve të regjimit iranian në Shqipëri, vitin e kaluar. Në deklaratën për media, policia tha se grupi i përkiste forcës elitare Quds, e cila zhvillon operacione të huaja për Gardën Revolucionare të Iranit. Kjo qelizë ka planifikuar, veç të tjerash, një akt terrorist në mars të vitit 2018, me në shënjestër një festë fetare të komunitetit bektashi në Tiranë, thuhet në deklaratë. Sipas saj, në këtë ceremoni merrnin pjesë edhe anëtarë të grupit të mërguar të opozitës iraniane, Muxhahedinët e Popullit të Iranit. "Celula terroriste drejtohet nga operativi i Forcave QUDS, i njohur si PEYMAN. PEYMAN është rezident i përhershëm në Iran dhe menaxhon në distancë një numër operativësh në Shqipëri dhe në vende të tjera në Evropën Qendrore dhe Perëndimore", tha Policia e Shqipërisë.

Në vitin 2013 Shqipëria ka rënë dakord për të pranuar qindra anëtarë të Muxhahedinëve të Popullit të Iranit, me kërkesë të Uashingtonit dhe Kombeve të Bashkuara. Ata aktualisht jetojnë në një kompleks në veriperëndim të këtij vendi. Në janar, Bashkimi Evropian ka sanksionuar shërbimet e inteligjencës së Iranit, pasi ka konstatuar se Teherani është përfshirë në komplote për t'i vrarë kundërshtarët e regjimit të tij në Holandë, Danimarkë dhe Francë.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Njohësit e proceseve politike në vend thonë se Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës nuk duhet të nguten që ta riorganizojnë tërë sistemin e qeverisjes

# A do të mund të zvogëlohet numri i ministrive në 12 sosh?

Synimin e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), që qeveria e re t'i ketë vetëm 12 ministri, e shohin të pamundshëm njohësit e proceseve politike në vend. Analisti politik Naim Rashiti ka thënë se LV-ja dhe LDK-ja mund ta zvogëlojnë numrin e ministrive, por nuk ka logjikë të mbesin vetëm 12 ministri. Kurse koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, i cili ka punuar në hartimin e projektligjit për qeverinë, ka thënë se numri i ministrive nuk duhet të jetë më i madh se 15 sosh



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 23 TETOR - Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të cilat janë pajtuar lidhur me përmbajtjen dhe parimet e marrëveshjes për bashkëqeverisje, synojnë që qeveria e tyre të ketë vetëm 12 ministri. Mirëpo njohësit e rrethanave dhe shoqëria civile e kanë vlerësuar të pamundshëm arritjen e këtij qëllimi. Ata kanë bërë me dije se numri i ministrive duhet të zvogëlohet, por nuk ka logjikë të mbesin 12 ministri.

Analisti politik Naim Rashit ka thënë se qeveria e re duhet t'i ketë 15 deri në 16 ministri sektoriale. "LV-ja dhe LDK-ja kanë hapësirë të madhe për ta përmirësuar qeverisjen, por ato nuk duhet të nguten që ta riorganizojnë tërë sistemin e qeverisjes, rigrupimin e disa sektorëve në një. Qasja e qeverisë në Kosovë duhet të jetë sektoriale dhe sektorët kyçë duhet të mbeten të formësuar në ministri", ka deklaruar ai, duke shtuar se kjo çështje shkon përtej një mandati qeverisës. "Numri i ministrive duhet të zvogëlohet, por nuk ka logjikë të bëhen 12. Integrimet evropiane nuk duhen të shkrihen etj. Mund të bëhen 15-16 ministri sektoriale. Organogrami dhe themelet e organizimit të qeverisjes janë çështje që tejkalojnë dhe shkojnë përtej një mandati qeverisës", ka vlerësuar Rashiti.

Edhe koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, i cili ka hartuar projektligjin për qeverinë, ka thënë se ky dokument parasheh zvogëlimin e zëvendëskryeministrave, ministrive dhe të zëvendësministrave. Ai ka bërë me dije se qeveria e ardhshme nuk duhet të ketë jo më shumë se 15 ministri. "Sipas projektligjit, qeveria do ta ketë kryeministrin, 2 zëvendëskryeministra (të emëruar nga radhët e ministrave), deri në 15 ministri, rreth 30 zëvendësministra, përgjysmim të numrit të këshilltarë politikë dhe nëpunës të kabineteve në 250. Si dhe nuk ka ministra pa portofol", ka thënë Tahiri.

Lideri i LV-së, Albin Kurti, i cili pritet të jetë kryeministër i ardhshëm, pas takimit që ka pasur me liderin e LDK-së, Isa Mustafa, dhe kandidaten e kësaj partie për kryeministre, Vjosa Osmani, ka treguar se janë pajtuar për zvogëlim të numrit të ministrive. Ai pati deklaruar se qeveria e tij do t'i ketë vetëm 12 ministri dhe 26 zëvendësministra. "U pajtuam që t'i zvogëlojmë ministritë nga 21 sa kanë qenë në keqqeverisjen e kaluar, në 12. Por, edhe të mos jenë më shumë se një e treta e zëvendësministrave nga keqqeverisja e kaluar dyvjeçare, të mos jenë rreth 80 prej tyre, por një e treta e asaj çfarë kishim. Gjithashtu, u pajtuam që 30 për qind të ministrave dhe të zëvendësministrave të jenë gra në kuadër të përpjekjeve tona për barazi gjinore", ka thënë Kurti.

Të mërkurën përfaqësuesit e dy partive, LV-së dhe LDK-së, janë takuar sërish për harmonizimin e programit qeverisës.

Pas këtij takimi Lumir Abdixhiku nga LDK-ja ka bërë me dije se zyrtarët e Vetëvendosjes kanë diskutuar për numrin e ministrive që do t'i ketë qeveria e ardhshme. Ai ka thënë se janë marrë vesh që qeveria e re t'i ketë vetëm 12 ministri. Në këtë kontekst, ai ka thënë se Ministria e Diasporës dhe ajo e Integrimit Evropian do të shkrihen në Ministrinë e Punëve të Jashtme. "Në veçanti sot kemi diskutuar për formatin e qeverisë së ardhshme, për 12 ministritë se si do të duken ato dhe se si do të fuzionohen ato në ditët e para të qeverisë. Për bashkim të ministrive, për shembull kemi bërë fuzionimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, të Integrimit Evropian dhe Diasporës në Ministri të Punëve të Jashtme dhe Integrime Evropiane. Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik e kemi propozuar në disa kategori të cilat si skenar final u propozohen liderëve tanë politikë. Pra, ajo që është me rëndësi, kemi punuar në 12 ministri, me nga dy zëvendësministra për secilën ministri", ka thënë Abdixhiku.

Qeveria në dorëheqje e Ramush Haradinajt vazhdimisht është kritikuar për numrin e madh të zëvendëskryeministrave, të ministrave dhe të zëvendësministrave, që ishin mbi 80.

## Institucioni i Avokatit të Popullit anëtarësohet me të drejta të plota në EQUINET

BRUKSEL, 23 TETOR (ER) - Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës u bë të mërkurën anëtari i 50 i Rrjetit Evropian të Organeve të Barazisë (EQUINET). Ky rrjet ka për mision promovimin e barazisë në Evropë, duke mbështetur dhe aftësuar organet e barazisë në punën e tyre, për të qenë të pavarur dhe efektivë në angazhimin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe trajtimi i pabarabartë.

Kërkesën e Institucionit të Avokatit të Popullit për të qenë anëtar me të drejta të plota në EQUINET e ka prezantuar Avokati i Popullit, Hilmi Jashari. Përkundër kundërshtimit formal nga ana e Serbisë, respektivisht notës së protestës nga ana e komisionarit për Mbrojtjen e Barazisë në Serbi, si dhe lobimit paraprak nga ana e tyre, me shumicë votash, anëtarët e EQUINET votuan për anëtarësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në këtë rrjet.

Anëtarësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës në Rrjetin Evropian të Organeve të Barazisë (EQUINET) është një sukses tjetër i radhës për këtë institucion dhe i shtohet listës së anëtarësimeve në strukturat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.






Flet për "Epokën e re", Blerim Reka

# SHBA-ja TË NDËRMJETËSOJË NË DIALOGUN MIDIS DY SHTETEVE KOSOVË - SERBI

## - Historia tash e një shekull kohë ka treguar se pa amerikanët nuk mbyllet asnjë problem në Ballkan. As ky midis Kosovës dhe Serbisë

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka vlerësuar se moshapja e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut është vendim i gabuar i Bashkimit Evropian. Ai ka thënë se është gabim strategjik mbetja e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor jashtë orbitës së BE-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Reka ka deklaruar se presidenti Macron pretendon të bëhet lideri evropian pas pensionimit të Merkelit dhe pas daljes së Britanisë nga BE-ja. Ai ka thënë se ka ardhur koha që ShBA-ja ta ndërmjetësojë dialogun midis dy shteteve Kosovë - Serbi. Reka ka theksuar se amerikanët u rikthyen në Ballkan kur e panë paaftësinë dhe dështimin e BE-së për ta ndërmjetësuar dialogun

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 TETOR - "Epoka e re": *Profesor, si e komentoni vendimin e Bashkimit Evropian (BE) për moshapjen e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut?*

**Reka:** Ky samit, përveç vendimit për mosdhënien e datës së negociatave për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, dha një mesazh më të gjerë. Dilema ishte nëse BE-ja do të vazhdojë me politikën e zgjerimit apo, ndoshta, nga ky samit mund të pritet një ndryshim në politikën e zgjerimit, për të mos thënë ndaljen e saj. Kur e them këtë kam parasysh deklaratën e presidentit të Francës, Emmanuel Makron, një ditë pas samitit i cili tha se 'ndoshta duhet menduar që jo medoemos shtetet e Ballkanit Perëndimor të bëhen një ditë anëtare të plota të BE-së'. Kjo i shtoji spekulimet në qarqet shkencore dhe diplomatike, se mos BE-ja, pas status kohës në zgjerim dhe pas pauzës 15-vjeçare, do të vë në pikëpyetje procesin e zgjerimit. Edhe në librin tim në vitin 2010 për gjeopolitikën e BE-së kam parashikuar këtë zhvillim duke konsideruar se BE-ja pas anëtarësimit të shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore nga ish-blloku sovjetik për shkaqe gjeopolitike do ta mbyllë kaptinën e Luftës së Ftohtë dhe në të ardhmen do të jetë më vështirë anëtarësimi i shteteve të tjera. Më 18 tetor BE-ja filloi të tërhiqet nga premtimet e saj në Samitin e Selanikut ku kishte proklamuar perspektivën evropiane për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Tani kam drojën dhe frikën se mos pas këtij samiti BE-ja do ta zëvendësojë politikën e zgjerimit me politikën e fqinjësisë evropiane e cila ka të bëjë me shtetet e ish-bllokut sovjetik, e cila politikë nuk nënkupton anëtarësim, por vetëm afrim të këtyre shteteve. Do të ishte vendim i gabuar strategjik i BE-së nëse i lënë gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor jashtë orbitës së BE-së, sepse kjo do të mund të krijonte një vakum strategjik i cili pastaj do të mbushej me lojtarë të tjerë joeuroatlantikë. Sipas mendimit tim, Macroni po tenton të bëhet lideri panevropian pas pensionimit të Merkelit dhe pas daljes së



Britanisë nga BE-ja. Macroni do të mbetet lideri i njërës nga fuqitë më të mëdha evropiane me çka do ta rikthejë formulën e njohur të Sharl De Gollit pas Luftës së Dytë Botërore: Franca mbi, Gjermania nën dhe Britania jashtë. Ai në atë kohë për dhjetë vjet ishte lider i pakontestueshëm evropian. Macroni e sheh veten pa Merkelin dhe pa një kryeministër britanik të pakontestueshëm në lidershipin e BE-së. Samiti i 18 tetorit sa ishte një samit kundër zgjerimit të BE-së ishte edhe një samit për katapultimin e Macronit si lider i ardhshëm evropian.

**"Epoka e re":** *Moshapja e negociatave ishte një vendim i padrejtë. Mendoni se nevojitet vazhdim i reformave?*

**Reka:** Kam qenë një nga kritikët më të mëdhenj të Maqedonisë së Veriut edhe të Shqipërisë për mosplotësim të reformave sidomos në sundimin e ligjit dhe në mosdërgimin e rezultateve për gjyqësor të pavarur, për luftë kundër korrupsionit e krimit të organizuar si dhe për depolitizim të administratës publike. Por është e padrejtë që Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut të lihen në korridorin e pritjes dhe atë duke i ndryshuar rregullat e lojës mu në mes të lojës. Iniciativa e presidentit Macron dhe arsyetimi i tij se do t'i rikthehemi kësaj çështje, por vetëm pasi të aprovohet një metodologji e re e cila nënkupton se kushtet do të jenë më të ashpra, procesi do të jetë më gradual dhe parimi reverzibil do të nënkuptojë që edhe kur mbyllet një kaptinë të rihapet nëse Brukseli konsideron se nuk ka përparim në terren. Maqedonia e Veriut pati marrë një vendim jashtëzakonisht të vështirë, pra e ndryshoj emrin kushtetues për shkak të presionit të një shteti anëtar i cili e bllokoi me veto për më se 15 vjet. Shqipëria nuk them se është shtet në të cilin lulëzon sundimi i ligjit por, megjithatë, nisi procesin e vetingut dhe shkarkoi disa gjyqtarë, mirëpo aty ende nuk ka Gjykatë Kushtetuese si dhe kryetari i Gjykatës Supreme dha dorëheqje para pak kohësh. Edhe pse ka shumë punë për t'u bërë në sundimin e ligjit mendoj se BE-ja me vendimin për të mos u dhënë datë për fillimin e negociatave Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut bëri gabim strategjik. Fundja nuk po flasim për anëtarësimin e këtyre vendeve në BE, por për fillimin e një procesi që mund të jetë 10 ose 15-vjeçar. Në çdo hapje dhe mbyllje të secilës kaptinë e që janë 35 sosh çdo shtet mund të përdorë minimum 70 veto dhe të bllokojë në çdo fazë anëtarësimin e secilit kandidat. Duhet më tepër punë dhe prova për sundimin e ligjit, por sa për fillim të negociatave Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut duhet ta fitonin datën.

**"Epoka e re":** *Sa është dekurajues ky vendim për vendet e tjera të Ballkanit përveç kur dihet se Rusia ka tendencë ta rrisë ndikimin në rajon?*

**Reka:** Serbia para katër vjetësh kur mori datën për fillim të negociatave nuk kishte ndonjë dosje shumë më të pastër në sundimin e ligjit se Maqedonia apo Shqipëria. Në atë kohë vetë burimet zyrtare të Serbisë flitnin për rreth 200 banda kriminele mafioze që vepronin atje, pra ishte larg sundimit të ligjit dhe luftimit të korrupsionit e krimit të organizuar. Por, meqë Komisioni Evropian aprovoi një dokument strategjik për t'i sanksionuar shtetet anëtare që nuk e zbatojnë sundimin e ligjit, duke u ndaluar fondet dhe duke u suspenduar të drejtën e votës në mbledhjet e Këshillit Evropian, çka mund të pritej nga KE-ja në raport me shtetet kandidate që aspirojnë të bëhen pjesë e BE-së. Megjithatë vendimi për moshapje të negociatave mund ta luhatë disponimin proevropian prej 80 përqindësh në Ballkan. Pas këtij vendimi që ka dekurajuar dhe zhgënjyer qytetarët nuk e di se si do të jetë përqindja e përkrahjes e këtij procesi. Mirëpo duhet të mbetemi në rrugën euroatlantike sepse Ballkani nuk ka alternativë tjetër strategjike. Procesi i integrimit mund të vonojë por, megjithatë, nuk duhet të tërhiqemi apo të dorëzohemi. Një ditë pas 'jo'-s së tretë të gjitha partitë politike, kryeministri dhe presidenti në një takim e rikonfirmuan mbetjen e Maqedonisë së Veriut në rrugën strategjike euroatlantike duke bërë të qartë se nuk ka tjetër alternativë. Do të doja që ky unitet të ishte edhe në Shqipëri dhe shpresoj se edhe Shqipëria do të mbetet në orientimin gjeostrategjik drejt BE-së.

**"Epoka e re":** *Pas vendimit të BE-së ishte e pritur shkuarja në zgjedhje të parakohshme e Maqedonisë së Veriut?*

**Reka:** Ishte i pritur ky vendim pas 'jo'-s së tretë, sepse me BE-në negocion ekipi i qeverisë dhe meqenëse qeveria e udhëhoqi këtë proces tash e dy vjet e gjysmë ishte normale shkuarja në zgjedhje. Në mënyrë që të mos ndëshkohet populli dhe shteti përgjegjësinë duhet ta marrë qeveria që udhëhoqi procesin.

**"Epoka e re":** *Vendimi i 18 tetorit do ta zbehë rolin e BE-së në dialogun Kosovë - Serbi?*

**Reka:** Dialogu i gabuar i Brukselit që ishte për shtatë vjet nuk duhet të vazhdojë më tutje. Dialogu midis Kosovës dhe Serbisë duhet të rikonfigurohet në një format dhe mandat të ri me mediatorë dhe parime të reja. Parimi i parë pa të cilin nuk bën të rifillojë çfarëdo dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë parimi i negocimit të dy shteteve dhe jo i negocimit të një shteti dhe një etniteti me fusnotë. Kjo ka qenë e patolerueshme dhe gabimi më i madh i BE-së, duke mos qenë neutrale në dialog, por ka qenë neutrale ndaj statusit të njërit shtet që negocion. Që në fillim me fusnotë theksonte se nuk prejudikohet statusi i Kosovës konform Rezolutës 1244 dhe mendimit të GjND-së por, në fakt, e prejudikoj asimetrinë apo pabarazinë në trajtimin e dy palëve, sepse njërën palë e pranon si shtet, kurse për palën tjetër nuk ka qëndrim statusor. Fjalia e fusnotës është kundërthënëse në vetvete sepse në një anë thirret në një rezolutë të cilën e ka shkelur koha tash e 20 vjet dhe nga ana tjetër thirret në GjND. GjND-ja thotë se deklarimi i pavarësisë së Kosovës nuk e shkel të drejtën ndërkombëtare, ndërkaq BE-ja thirret në Rezolutën 1244 që nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, edhe më keq ende thirret në një rezolutë ku në pikën 11 të së cilës Kosova është pjesë e të ashtuquajturës RFJ pra një shteti që nuk ekziston tash e 15 vjet. Një dialog i gabuar, siç ishte ai i mediuar nga BE-ja, krijoi vetëm një neutralitet asimetrik që dëmtoi shumë Kosovën. Serbia përfitoi duke hapur gati gjysmën e kaptinave si dhe progresi në integrimet evropiane, ndërkaq Kosova mezi nënshkroi MSA-në dhe nuk u liberalizuan vizat sepse trajtimi që i bëri BE-ja ishte denigrues dhe nënçmues. Fatmirësisht u ndërpre ky dialog sepse nga dialogu për normalizimin e marrëdhënieve midis dy shteteve, BE-ja gati e shndërroi në dialog për diskutimin e statusit të Kosovës i cili ka përfunduar më 17 shkurt 2008.

**"Epoka e re":** *Do të ketë dialog më përmbajtjesor dhe të suksesshëm nën drejtimin e kryeministrit Kurti?*

**Reka:** Kryeministri i ardhshëm i Kosovës duhet të jetë udhëheqës i dialogut. Pra, dialogu duhet të rikthehet në nivel të kryeministrave, sepse qeveria është organ ekzekutiv, por vetëm me kushtin që të gjendet një mediator neutral, jo si BE-ja që ishte e pabarabartë ndaj Kosovës dhe se ky proces të rifillojë si dialog midis dy shteteve.

**"Epoka e re":** *Pas përfshirjes së ShBA-së, ka gjasa që dialogu të zhvillohet në binarë të duhur dhe të arrihet marrëveshja finale?*

**Reka:** ShBA-ja u përfshi kur e pa paaftësinë dhe dështimin e BE-së për ta ndërmjetësuar dialogun. U përfshi kur e pa që BE-ja jo shtatë, por 70 vjet s'mund t'i normalizojë marrëdhëniet Kosovë - Serbi. Rikthimin amerikan në Ballkan, në veçanti në raportin Kosovë - Serbi, e shoh me shumë shpresë sepse historia tash e një shekull ka treguar se pa amerikanët asnjë problem nuk mbyllet e as ky midis Kosovës dhe Serbisë. ShBA-ja duhet ta ndërmjetësojë këtë dialog. Edhe ashtu ishte mediatore e paqes së Dejtonit. Pa amerikanët nuk do të mund të arrihej as procesi i Rambujesë dhe as Marrëveshja e Ohrit. Është koha që ShBA-ja ta zëvendësojë BE-në në ndërmjetësimin e dialogut Kosovë - Serbi.



## 6 tetori, model se si duhet të jetë një ditë zgjedhore

**"Epoka e re":** *Z. Reka, si e shihni procesin e formimit të institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet e 6 tetorit?*

**Reka:** Procesi i 6 tetorit është një leksion i demokracisë nga i cili mund të mësojë i tërë rajoni dhe më gjerë. Ishte proces i rregullt, kaloi pa incidente e tensione dhe humbësit pranuan rezultatin. 6 tetori është model se si duhet të jetë një ditë zgjedhore. Megjithatë, rinumërimi filloi t'i hedhë pak hije shkëlqimit të 6 tetorit sepse gati 20 ditë pas ende nuk ka rezultat final. Duhet të mësohemi me ndërrimin e pushtetit dhe nuk e di pse vetëm në Ballkan duhet të jetë lajm i ditës që opozita e mund pozitën. E kuptoj mentalitetin ballkanik që pozita e ka të paragjykuar fitoren, por kjo duhet të ndryshojë. Është proces normal i tranzicionit të pushtetit dhe nuk ka asgjë të jashtëzakonshme. Sa më shpejt që të formohet qeveria e re do të jetë më mirë sepse Kosovën e presin shumë punë. Në planin e brendshëm e pret lufta e pakompromis ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar e në planin ndërkombëtar e pret lufta për ndërprerjen e izolimit të mëtejmë të Kosovës.

# Policia fillon edhe kontrollet teknike të veturave

Policia e Kosovës në rajonin e Gjilanit tashmë ka filluar edhe një operacion dhjetëditor i cili titullohet "Kontrollet e jashtëzakonshme teknike". Kontrollet e jashtëzakonshme teknike janë fokusuar në identifikimin e automjeteve që qarkullojnë në rrugë dhe dyshohet se nuk janë në gjendje të mirë teknike



EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 23 tetor** - Policia e Kosovës në rajonin e Gjilanit tashmë ka filluar edhe një operacion dhjetëditor i cili titullohet "Kontrollet e jashtëzakonshme teknike". Një operacion i tillë ka filluar më 21 tetor dhe do të përfundojë më 31 tetor. Vetëm për dy ditë në komunikacion janë ndaluar 17 automjete, pronarët e të cilave më pas policia i ka detyruar që të bëjnë kontrolle urgjente teknike. Nga këto 17 vetura të ndaluara, 11 kanë qenë kombi, 3 vetura, 2 vetura pikap dhe një kamion. "Gjendja teknike e automjeteve që qarkullojnë në rrugët tona ka një rëndësi të veçantë për rritjen e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në trafikun rrugor, andaj kontrollimi dhe verifikimi i gjendjes teknike të tyre do t'i rrisë edhe më tepër synimet tona në drejtim të rritjes së sigurisë dhe preventivës së përgjithshme për të gjithë pjesëmarrësit në trafikun rrugor brenda zonës së përgjegjësisë DRP Gjilan", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Në këtë njoftim policia ka treguar edhe për planin operativ. "Policia e Kosovës, njësitë e Trafikut Rajonal, përmes planit operativ 'Kontrollet e jashtëzakonshme teknike' është fokusuar në identifikimin e automjeteve që qarkullojnë në rrugë dhe dyshohet se nuk janë në gjendje të kënaqshme teknike dhe ndërmarrin masa duke u bazuar në nenin 252 të LRRTRR për të krijuar një klimë sigurie për të gjithë pjesëmarrësit në trafikun rrugor", është bërë me dije në njoftimin e policisë.

# Shqyrtohet draftdokumenti i treguesve për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 23 tetor** - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI), së bashku me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR), organizuan takimin konsultativ për shqyrtimin e draftdokumentit "Treguesit për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë". Në takim pjesëmarrës ishin përfaqësues të ministrive të linjës, të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të komunave dhe të Agjencive për Zhvillim Rajonal dhe të shoqërisë civile. Gjatë takimit u prezantua qëllimi i përcaktimit të këtyre treguesve, të cilët janë pjesë e dokumentit që është duke u hartuar, i cili është në funksion të ndërtimit të sistemit për matjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë.




Dokumenti është në funksion të ndërtimit të sistemit për matjen e performancës rajonale, i cili synon t'i pasqyrojë investimet e nivelit qendror në nivel lokal dhe rajonal, ta promovojë zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar si dhe ta stimulojë konkurrencën ndërmjet rajoneve. Andaj synohet të përcaktohet rruga e sigurimit të informatave për t'i pasqyruar zhvillimet socio-ekonomike në pesë rajonet zhvillimore të Kosovës përmes dokumenteve analitike të cilat do të zhvillohen çdo vit. Në këtë kontekst, janë shumë të nevojshëm zhvillimi, menaxhimi dhe promovimi i projekteve që sigurojnë zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar në gjithë territorin e Kosovës. Para së gjithash, nxitja e rrjetëzimeve dhe promovimi i formave të bashkëpunimit ndërmjet komunës me aktorët e tjerë zhvillimorë në kontekst të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Instituti KLGI mbetet i përkushtuar që në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe me komuna të përgatitin dokumente që ndikojnë në avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar. Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit 'Mbështetje për komuna më të forta dhe më të qëndrueshme', i financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë.

## Poeti Lulzim Tafa, i ftuar nderi në Festivalin e Poezisë në Itali

**Prishtinë, 23 tetor (ER)** - Poeti i shquar kosovar Lulzim Tafa do të qëndrojë në Itali si i ftuar nderi në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë që do të mbahet për katër ditë me radhë, nga 25-28 tetor, në Taranto të Italisë. Në këtë festival Tafa do të nderohet me çmimin kryesor të festivalit, Çmimin e Madh "Neruda 2019". Festivali që organizohet nga Asociacioni Kulturor Italian për ndërlidhje kulturore me botën ka një traditë shumëvjeçare dhe është ndër festivalet më të njohura të poezisë në Itali. Në këtë ngjarje të madhe ndërkombëtare që bëhet në nderim të njërit prej poetëve më të mëdhenj të botës të shekullit XX, Pablo Neruda, do të marrin pjesë emra të mëdhenj të poezisë nga shumë vende të botës.

Poeti Lulzim Tafa është bërë i njohur për lexuesit e poezisë në Itali me librin "La Cronica di unasanta Guerra".

Çmimi "Neruda 2019" i shtohet listës së gjatë të çmimeve prestigjioze ndërkombëtare të poezisë që Tafa i ka fituar ndër vite.



# Presidenti Thaçi dekoroi miqtë japonezë që promovuan Kosovën

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Tokyo, 23 tetor - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka ndarë dekorata për zyrtarë dhe personalitete nga Japonia që kanë kontribuar në Kosovë dhe për Kosovën, në një ceremoni të organizuar në ndërtesën e Kuvendit të Japonisë në Tokyo.

Yuriko Koike, që aktualisht është guvernatore e Tokyos, e cila ka ndihmuar Kosovën në kapacitetet e tjera zyrtare që ka mbajtur, ndër të tjera duke ndihmuar edhe në sigurimin e strehimit për qindra kosovarë të kthyer në shtëpitë e tyre në vjeshtën e vitit 1999, është dekoruar me Medaljen Presidenciale "Shën Nënë Tereza". Çmimi "Ambasador Nderi i Republikës së Kosovës" i është ndarë edhe Ryu Shionoya, kryesues i Grupit të Miqësisë Kosovë - Japoni në Kuvendin e Japonisë, për kontributin e tij për promovimin e Kosovës në Japoni.

Konsulli i Nderit i Republikës së Kosovës në Japoni, njëherësh këshilltar special i kryeministrit të Japonisë, Isao Iijima, është nderuar me çmimin "Ambasador Nderi i Republikës së Kosovës" për promovimin dhe afirmimin e interesave të Republikës së Kosovës në Japoni dhe më gjerë.





Ambasadori Yoshifumi Okamura, i cili ka shërbyer si Këshilltar i PSSP-së në kuadër të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, që në Kosovë më së miri njihet si ambasadori japonez në Kombet e Bashkuara, i cili e ka promovuar verën kosovare në Këshillin e Sigurimit të KB-së, i është ndarë titulli "Dr. Ibrahim Rugova" për kontributin e tij në ndërtimin e paqes dhe zhvillimin e demokracisë në Kosovë.

Ish-administratorit të UNMIK-ut në Skenderaj, Ken Inoue, i është ndarë Medalja Presidenciale "Shën Nënë Tereza" për kontributin e tij në fushën e humanizmit dhe paqes në Kosovë, veçanërisht për angazhimin e tij personal për shërimin e atëhershëm të vajzës së vogël Besjana Musliu, e cila kishte pësuar djegie të rënda në kokë gjatë luftës. E njëjta medalje dhe me pretekst të njëjtë i është ndarë edhe Agjencisë ADRA dhe Spitalit Adventist në Tokyo.

Në këtë ceremoni të organizuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Tokyo të Japonisë ka marrë pjesë edhe presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta. Presidenti Thaçi u shpreh se ndien obligim, por edhe privilegj, që t'u shprehë mirënjohje atyre që bënë gjënë e duhur në kohën e duhur. "Nuk thuhet kot se miqtë dihen në kohë të vështira", u shpreh presidenti Thaçi dhe shtoi se sot Kosova është partnere e bashkësisë ndërkombëtare dhe ka filluar t'i japë botës më shumë sesa që merr "duke i ofruar botës talente dhe shkathtësi në shumë fusha, nga teknologjia e deri te sporti dhe arti". "Dua që sot, duke treguar falënderimin për ju, bashkërisht ta shënojmë hyrjen në dekadën e dytë të bashkëpunimit tonë, ku Kosova nuk shihet më si vend që duhet ndihmuar, por si vend me të cilin vendoset partneriteti që evoluon drejt një raporti fitim-fitim për të dyja vendet", u shpreh presidenti Thaçi.

Ai ka thënë se është thellësisht i bindur që në dekadën që vjen Kosova do t'i thellojë raportet me Japoninë, në politikë, ekonomi, siguri, kulturë dhe arsim.

# KQZ-ja: Nuk ekziston rrezik për zarfet e mbetura që erdhën nga Serbia

Prishtinë, 23 tetor (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka verifikuar zarfet me fletëvotime që kanë ardhur nga Serbia dhe, pas kontrolleve nga organet kompetente, është konstatuar se nuk ekziston rrezik i mëtejmë për procedimin e këtyre zarfeve të mbetura.

Verifikimi i këtyre zarfeve është bërë me maska. Sipas KQZ-së, nën masa të caktuara mbrojtëse këto zarfe mund të procedohen më tutje. "Ky proces, siç dihet, ka qenë ndërprerë më 13 tetor për shkak të ankesave shëndetësore të zyrtarëve që kanë punuar me zarfet e ardhura nga Serbia dhe dyshimeve për praninë e një materie të rrezikshme. Prokuroria dhe Policia kanë filluar zhvillimin e hetimeve dhe kanë marrë provat dhe dëshmitë e nevojshme (materiale të dyshuara si të kontaminuara) dhe procesi i hetimeve është duke vazhduar. Pas verifikimeve dhe kontrolleve nga organet kompetente të zhvilluara gjatë këtyre ditëve, sot është konstatuar se tashmë nuk ekziston rrezik i mëtejmë për procedimin e këtyre zarfeve të mbetura dhe nën masa të caktuara mbrojtëse mund të procedohen më tutje. Pavarësisht prej komplikimeve që janë shfaqur gjatë këtij procesi, KQZ-ja është e përkushtuar që ta ruajë integritetin e procesit zgjedhor, sigurinë e zyrtarëve operues dhe, po ashtu, edhe procesin e zbardhjes së këtij rasti", është thënë në njoftimin e KQZ-së. Ky institucion ka falënderuar organet kompetente për bashkëpunimin e ofruar gjatë kësaj kohe.



## Kurti pranon urime nga liderë rajonalë për rezultatin e zgjedhjeve të 6 tetorit



Prishtinë, 23 tetor (ER) - Fituesi i zgjedhjeve të 6 tetorit, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se gjatë dy javëve të fundit ka pranuar telefonata, mesazhe dhe letra urimi për rezultatin dhe suksesin e kësaj partie në zgjedhjet e parakohshme parlamentare.

Kurti ka thënë se ka pranuar mesazhe urimi nga kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, kryetari i Kryesisë së Bosnjë dhe Hercegovinës, Zeljko Komsiq, nënkryetari i Kuvendit të Malit të Zi, Genc Nimanbegu dhe ish-presidenti i Kroacisë, Stjepan Mesiq, e shumë të tjerë. "Me bashkëpunim të ngushtë me partnerët fqinjë e miqtë tanë do të jemi një hap përpara zhvillimit dhe integrimit tonë. U jam mirënjohës të gjithëve për urimet, përgëzimet dhe gatishmërinë e shprehur për mbështetje", ka thënë Kurti në deklaratën për media.

# Klubi i Prodhuesve dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosova inauguruan punëtorinë 'Made in Kosova'



PRISHTINË, 23 TETOR (ER) - Klubi i Prodhuesve të Kosovës dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosova sot inauguruan punëtorinë 'Made in Kosova', qëllimi i së cilës është krijimi i një hapësire e cila mundëson socializmin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e të rinjve për orientimin në karrierë.

Klubi i Prodhuesve, në bashkëpunim me fondacionin ERTEV, është angazhuar që përmes punëtorisë 'Made in Kosova' t'i ndihmojë fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe në rrezik të cilët përkrahen nga programet e SOS Fshatrave të Fëmijëve në Kosovë.

Punëtoria 'Made in Kosova' synon t'i arrijë objektivat kryesore, si: krijimin dhe ngritjen e vetëbesimit si dhe marrjen e përgjegjësive nga të rinjtë, të mësuarit mbi njohuritë bazike teknike, nxitjen e kreativitetit, mendimin inovativ dhe zgjidhjen e problemeve, informimin dhe përgatitjen për orientimin në karrierë në të ardhmen.

Gjatë ceremonisë inauguruese, kryetari i Klubit të Prodhuesve, Fejzulla Mustafa, u shpreh se ky klub, përveç aktiviteteve dhe punëve të cilat i ka të përditshme, ka filluar përfshirjen dhe përkrahjen dhe ndihmën me projekte edhe për SOS Fshatin. "Kjo punëtori do ta bëjë aftësimin profesional për gjeneratat që po vijnë dhe ky do të jetë vetëm fillimi për zgjerimin në projekte të tjera për të rinjtë", ka thënë ai.

Astrit Panxha, drejtor ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve, ka falënderuar SOS Fshatin për hapësirën e dhënë në këtë projekt, posaçërisht ka falënderuar partnerin e Klubit, fondacionin ERTEV, në veçanti Fahrettin Gülener, që së bashku mundësuan realizimin e këtij projekti. "Shpresojmë që këta të rinj do të punësohen në të ardhmen në fabrikat e anëtarëve tanë", ka thënë Panxha.

Ndërsa drejtoresha nacionale e SOS Fshatrave, Nezahat Salihu, ka thënë se organizata e SOS Fshatrave kujdeset për fëmijë duke investuar në edukimin profesional të tyre. "Me ndihmën dhe përkrahjen e Klubit është mundësuar kjo punëtori e cila do të kultivojë një kulturë pune te të rinjtë tanë, do të jetë hapësirë për mësimnxënie dhe aftësim profesional", ka deklaruar ajo.

Punëtoria 'Made in Kosova' përmban programe të cilat janë aktivitete passhkollore alternative për fëmijët dhe të rinjtë të moshës 8 deri 21 vjeç, ku do të përfshihen klasa e drurit, klasa metalike, programimi 3D dhe klasa e origamit. Punëtoria gjendet në SOS Fshatrat e Fëmijëve në Velani, Prishtinë.

# Për 125 asete AKP-ja pranon 79 ofertues




Prishtinë, 23 tetor (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) të mërkurën në ceremoninë e hapjes së ofertave Shitja e Aseteve në Likuidim - 51 përmes metodës së likuidimit shpalli çmimet më të larta të ofruara për asetet e ndërmarrjeve shoqërore që ishin në dispozicion për shitje. Për 125 asete sa ishin në shitje konkurruan 79 ofertues, ndërsa vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 3,126,433 euro.

Dorëzimi i ofertave nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve u bënë në mënyrë transparente para përfaqësuesve të mediave, përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm, ndërkaq është bërë transmetimi i drejtpërdrejtë i ceremonisë përmes faqes zyrtare të internetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit: www.pak-ks.org, duke mundësuar përcjelljen e ceremonisë edhe për të gjithë qytetarët e interesuar që s'kanë qenë të pranishëm në sallë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe është e shtrirë dhe vepron në të gjithë territorin e vendit. Agjencia ka mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve investitorëve private-blerësve, ose likuidimin e tyre, gjithnjë përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

# Hapet Panairi Ndërkombëtar 'Agrokos', marrin pjesë mbi 100 kompani

Në Prishtinë, në Sallën "1 Tetori", është hapur Panairi Ndërkombëtar i Agrobiznesit, Ushqimit dhe Pijeve "Agrokos", në të cilin po marrin pjesë mbi 100 kompani nga vendi, rajoni dhe më gjerë. Ky panair është cilësuar si mundësi e mirë për promovim të produkteve, por edhe për lidhje kontraktuale të bizneseve nga ana e pjesëmarrësve, ndërsa do të jetë i hapur deri më 25 tetor

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 TETOR - Panairi Ndërkombëtar i Agrobiznesit, Ushqimit dhe Pijeve "Agrokos" është hapur të mërkurën në Prishtinë, në sallën "1 Tetori", në të cilin po marrin pjesë mbi 100 kompani nga vendi, rajoni dhe më gjerë. Ky panair do të jetë i hapur tri ditë dhe është cilësuar si mundësi e mirë për promovim të produkteve, por edhe për lidhje kontraktuale të bizneseve nga ana e pjesëmarrësve.

Bekim Xhafa, organizator i këtij panairi, ka thënë se Panairi Ndërkombëtar i Agrobiznesit, Ushqimit dhe Pijeve "Agrokos" është mundësi e mirë për bizneset vendëse që t'i promovojnë produktet e tyre si dhe është transformuar në pikëtakim të domosdoshëm të bizneseve ndërkombëtare që dëshirojnë të shtrihen në tregjet e Ballkanit. "Pa dyshim këto vite i kemi bërë bashkë dhe dua t'i falënderoj partnerët dhe shoqatat e bizneseve që vijnë nga rajoni dhe ato vendëse. Nuk kanë munguar as produktet që vijnë nga Shqipëria e që për këto vite kanë sjellë përvoja të ndryshme", është shprehur ai, përderisa ka thënë se, pavarësisht prej premtimeve nga qeverisja e ardhshme që do të marrin pjesë në këtë panair, kjo gjë s'ndodhi. "Qeveria në ardhje na ka premtuar që vijnë por, siç duket, nuk janë gati të marrin përgjegjësi, por ne i fusim në përgjegjësi", ka deklaruar Xhafa.

Edhe përfaqësuesi i Odës Ekonomike të Federatës së Bosnjës, Emir Pashiq, ka thënë se në këtë panair po marrin pjesë 17 kompani nga ky shtet, sipas të cilit, shprehin interesim për bashkëpunim. Ndërsa përfaqësuesja e Odës së Afarizmit të Kosovës, Qëndresa Ibrahimi, ka thënë se ky panair është një ngjarje me rëndësi për zgjerim të biznesit dhe krijimit të kontakteve me partnerë. Ajo ka ftuar bizneset që t'i japin prioritet edhe sektorit të bujqësisë ngaqë është shtytës i zhvillimit. Pjesë e këtij panairi janë edhe kompanitë që merren me paketimin, ambalazhimin e produkteve bujqësore, si dhe institucionet shtetërore e financiare që me politikat e tyre ndikojnë në zhvillimin e sektorit të agrobiznesit.

Panairi i edicionit të 19 do të jetë i hapur nga 23 deri më 25 tetor.



## 173 pajisje bujqësore ndahen për fermerët e Rahovecit

RAHOVEC, 23 TETOR (ER) - Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural sot ka bërë shpërndarjen e 173 mekanizmave bujqësorë për një pjesë të fermerëve përfitues, konkretisht: 40 motokultivatorë, 30 shpërndarëse plehu, 35 spërkatëse, 22 makina mjelëse dhe 46 plugje. Në ceremoninë e shpërndarjes së mekanizmave bujqësorë pjesëmarrës ishin edhe kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, nënkryetari i Komunës, Fatmir Iska dhe drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Berat Duraku.

Zyrtarët e kësaj komune kanë bërë me dije se në ditët në vazhdim do të bëhet shpërndarja e pjesës tjetër të mekanizmit bujqësor në bazë të furnizimeve të cilat do të pranohen nga kompanitë me të cilat ka lidhur kontratë Komuna e Rahovecit.

Ndërkaq, një prej përfituesve të një kultivatori, Asllan Krasniqi, ka pohuar se kjo do t'i shërbejë më shumë për vreshta, por edhe për produkte të tjera.



## Katër persona arrestohen në Prizren për fajde



PRIZREN, 23 TETOR (ER) - Në Prizren janë arrestuar katër persona pasi dyshohet se kanë kryer veprën penale "fajde dhe detyrim". Atyre i është kontrolluar shtëpia dhe janë sekuestruar pesë vetura, dokumente të ndryshme, 37 200 euro para të gatshme, 320 franga zvicerane dhe 12 telefona mobilë. Me vendim të prokurorit të dyshuarit janë dërguar në mbajtje.

# Në Gjilan ndalohet një person për 241 gramë 'marijuanë'

GJILAN, 23 TETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka ndaluar të dyshuarin A. Sh. në kohëzgjatje prej 48 orësh për shkak të dyshimit se tek i njëjti janë gjetur 241 gramë narkotikë e llojit 'marijuanë'.
Ekziston dyshimi i bazuar që më 22 tetor, rreth orës 12:30 minuta, i dyshuari A. Sh., pa autorizim dhe me qëllim të shitjes, ka poseduar substanca narkotike me ç'rast, gjatë bastisjes nga ana e policisë, në shtëpinë e tij, në Gjilan, janë gjetur 241 gramë substancë narkotike. I dyshuari kishte tentuar të ikte nga policia, pasi kishte qenë duke bërë paketimin e narkotikëve në objektet përcjellëse të shtëpisë së vet, e që gjatë bastisjes janë sekuestruar: një qese plasmani me substancë narkotike e llojit 'marijuanë' me peshë prej 183.9 gramësh, 24 paketime të vogla 'marijuanë', si dhe një sasi e ndarë në pjesë të vogla e gatshme për paketim, me peshë prej 57.1 gramësh dhe 400 paketime të vogla të cilat shërbejnë për paketimin dhe shitjen e 'marijuanës'.



# Zyrtarja e Ambasadës Amerikane viziton bibliotekën e qytetit në Malishevë



MALISHEVË, 23 TETOR (ER) - Udhëheqësja e bibliotekës së qytetit në Malishevë, Hana Bytyçi, me bashkëpunëtorët nga sektori i arsimit dhe rinisë dhe të Muzeut, përkatësisht, drejtorit për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, atij nga sektori i Rinisë, Mehdi Krasniqi dhe zyrtarit të Muzeut, Zymer Zogaj, pritën në takim dhe bashkëbiseduan me Ray Nayler, zëvendësdrejtoreshë për marrëdhënie me publikun në Ambasadën Amerikane, Besim Kokollari, zyrtar për biblioteka dhe Rina Musa, zyrtare për rini.
Përgjegjësja e bibliotekës së qytetit, Hana Bytyçi, i njoftoi mysafirët me punët dhe aktivitetet që zhvillohen në kuadër të bibliotekës së qytetit, duke filluar që nga pajisja me tituj të rinj të librave për fëmijë, romane, lektyra shkollore dhe tituj shkencorë. Bytyçi ka treguar se në bibliotekë ka edhe libra në gjuhën angleze, gjermane si dhe ka theksuar se organizojnë aktivitete letrare për lexuesit. "Kemi javën e bibliotekës, mbajmë orën poetike, shpërblejmë lexuesin e vitit, bashkëpunojmë me shkolla, shoqata kulturore që ushtrojnë aktivitetet e tyre brenda komunës sonë", ka thënë ajo.
Ray Nayler, zëvendësdrejtoreshë për Marrëdhënie me Publikun në Ambasadën Amerikane, ka vlerësuar lart këtë angazhim të punëtorëve të bibliotekës së qytetit me fondin e librave që ka. "Për një kohë kaq të shkurtër shihet se keni bërë punë të madhe edhe në bibliotekë, edhe në Muzeun e qytetit, duke e pajisur me tituj të shumtë si dhe me artefaktet që dëshmojnë të kaluarën tuaj të largët dhe të afërme që nga lufta juaj çlirimtare, prandaj mbështetja jonë do të jetë e përhershme për këta sektorë që ndikojnë drejtpërdrejt në formimin dhe zhvillimin e arsimit e të rinjve si dhe për ta treguar historinë dhe identitetin tuaj kombëtar", është shprehur Nayler.

# Shënohet dita e shkollës 'Motrat Qiriazi' në Klinë



KLINË, 23 TETOR (ER) - Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Motrat Qiriazi" në Klinë, me disa aktivitete kulturore-edukative ka shënuar ditën e shkollës. Në këtë shënim të ditës së kësaj shkolle të pranishëm kanë qenë kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë të tjerë, përfaqësues të Policisë së Kosovës, mësues, nxënës të kësaj shkolle dhe qytetarë.
Para të pranishëmve kryetari Elezaj ka uruar nxënësit dhe mësimdhënësit për shënimin e ditës së shkollës. "Ndihem i lumtur që sot po e shënojmë një festë të përbashkët, ditën e shkollës suaj dhe tonën. Çdo njeri dhe çdo institucion e ka një motiv për më shumë punë, për më shumë suksese, kurse nxënësit dhe punëtorët e shkollës suaj gjithmonë duhet të bazohen në shëmbëlltyrën arsimore dhe atdhetare të pishtareve të arsimit motrave Qiriazi, emrin e të cilave me dinjitet e mban kjo vatër e dijes dhe e arsimit tonë. Këto ngjarje madhore, po ashtu, na bën të ndihemi krenarë për rezistencën, sakrificat, por edhe të arriturat që ka pasur kjo vatër e dijes për shumë dekada të jetës së saj, e cila mbijetoi në kohët më të egra të rrugës së saj historike", ka thënë Elezaj.

## Nis asfaltimi i rrugëve në Zllatar të Ferizajt

Ferizaj, 23 tetor (ER) - Komuna e Ferizajt ka njoftuar se ka filluar asfaltimi i të gjitha rrugëve në fshatin Zllatar. "Pas disa vjetësh harresë, qeverisja Aliu kthen investimet në Zllatar. Së shpejti përmbyllet asfaltimi i të gjitha rrugëve në këtë fshat. Zllatari është shembulli se si zonave të harruara për vite me radhë nga pushteti lokal po i kthehen investimet duke i dhënë dimension të ri zhvillimit të fshatit dhe jetës së banorëve të kësaj ane të Ferizajt. Janë plot 18 rrugë të planifikuara që do të asfaltohen nga qeverisja Aliu për gjithë fshatin Zllatar, të cilat përfundimisht zgjidhin problemet me infrastrukturën rrugore, të munguar për dekada me radhë", ka njoftuar Komuna e Ferizajt.
Të mërkurën është bërë asfaltimi i njërës nga arteriet më të rëndësishme të Zllatarit në kuadër të projektit 220 mijë eurosh për finalizimin e infrastrukturës rrugore në këtë fshat. Për t'i përcjellë punimet në këto rrugë ka dalë në terren kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, bashkë me drejtorin e Infrastrukturës, Arbër Bytyqi. Ky i fundit ka thënë se me këtë projekt qeverisja lokale finalizon gjithë infrastrukturën rrugore në këtë fshat, duke ndikuar kështu edhe në cilësinë e jetës së banorëve.



# Vite të humbura, pas 14 vjetëve të Edi Ramës si 'lider i së majtës'



Nga Bedri ISLAMI

14 vjet më parë, kur socialistët, pas dorëheqjes së liderit të tyre, Nano, i cili iku pas zgjedhjeve të humbura të vitit 2005, do ta zgjidhnin drejtuesin e ri dhe, si dihet, në garë ishin Meidani dhe Rama, një njeri i mençur, duke folur me disa nga drejtuesit e njohur, u tha se do të bënin mirë ta zgjidhnin të parin. Kur ata e kundërshtuan, miku i tyre shtoi se "Meidanin, po të doni, e largoni pas dy vjetëve, ndërsa Edi Ramën, edhe po të doni, nuk e largoni më, në të kundërtën, do t'ju heqë ai juve".

U bënë 14 vjet që nga ajo kohë. Disa nga figurat themeluese nuk janë më aty, në elitën drejtuese të së majtës, u larguan nga mosha, nga dëshira e tyre apo nga nënvlerësimi, kjo është diçka tjetër, por fakti është se nuk janë më. Por, kjo nuk është thelbësore.

Koha ka ardhur, pas 14 vjetëve lider i së majtës, çfarë risie ka sjellë; është moderuar më tej e majta apo është mbyllur ajo në një rreth të ngushtë; është krijesa Rilindja një elitë e së majtës apo një sekt politik që i ka hipur asaj në qafë dhe që, bashkë me oligarkët financiarë, kanë krijuar një gjendje të re politike; është hapur ajo, e majta, për të rinjtë që aspirojnë një Shqipëri ndryshe apo, pas vrullit dhe besimit të parë, portat janë mbyllur dhe dritëzimi që kishin parë nuk është më; ka në të majtën shqiptare diçka nga tradita e saj apo nga e majta evropiane apo është kthyer në një amalgamë bindjesh dhe heshtjesh të pafundme, që nuk kanë të bëjnë me asnjë rrymë politike; ku është pjesa e mendimit intelektual apo gjithçka është kthyer në një memecëri të heshtur; deputetët e saj janë vërtet ata që duhet të jenë apo është bërë një grumbullim pazaresh dhe votash, të cilat më shumë diktohen nga forca sesa nga mendja?

Në fund të fundit, kemi të bëjmë me një periudhë 14-vjeçare të rritjes së mendimit apo ishin, edhe një herë, vite të humbura apo gjysmë të humbura.

Tetë vjet në opozitë dhe, pothuaj, kaq në pushtet, kanë krijuar dy figura lideri në një të vetëm: fillesën e një reformatori dhe kthimin e një diktati. Kur Rama, pas zgjedhjes së tij në kreun e PS-së, më shumë nga bijtë dhe bijat që detyruan etërit të votonin për të, deklaroi se mbaruan serialet e famshme të KPD-së, shumë nga e majta u ndien të lehtësuar pasi, si kudo, jo e gjitha ishte e qartë, e duhur dhe e domosdoshme. Por askush nuk e diti e as nuk e mori me mend se, pas "mbylljes" së serialeve politike do të binte heshtja e detyruar politike, mbyllja e mendimit dhe vizionit, çka ishte po aq e rëndë, në mos më e rëndë sesa mbyllja.

Diktati i Njëshit po bëhet po aq i rëndë sa në PD-në e Berishës. Forca e Njëshit po bëhet po aq asfiksuese për mendimin ndryshe. Mjaftoi një fillesë kundërshtimi nga ish-ministri i Jashtëm, Bushati dhe ai u gjet jashtë kabinetit qeveritar, por edhe më përtej saj. Nga të gjithë ish-ministrat, megjithëse më pak i përfolur, ai do të jetë i vetmi që nuk do të ketë as postin partiak, si drejtues i së majtës në Shkodër dhe, në vendin e tij, pa mëdyshje dhe pa i thënë asnjë strukture, Rama vendosi një delikuent, të cilin, deri atë kohe nuk e njihte askush dhe, mjerisht, dihet se çfarë doli prej tij.

Nga ideja e mendimit kolegjial, jo menjëherë, por sidomos pas ndryshimeve kobzeza 2008, u rrit në përmasa të frikshme roli i liderit dhe të gjithë strukturat e tjera heshtën. Tani asgjë nuk ka më rëndësi para mendimit të tij, i cili, edhe sikur të ishte dhjetë herë më i mençur dhe më i ditur, përsëri do ta kishte pasur nevojën e një mendimi ndryshe, të cilin, dikur kishte paralajmëruar se, edhe nëse nuk do e kishte në parti, do e nxiste të ishte.

Në natën, do të thosha, tejet të hidhur, kur në Bashkimin Evropian do të vendosej e ardhmja e afërt e Shqipërisë, mendimi politik e qeverisës ishte diku tjetër. Ata, si pa të keq, pa ia ndjerë se çfarë ndodh në Bruksel, kaluan një ligj të llahtarshëm, Krijimin e Korporatës Shqiptare për Investime, si oktapod oligark, i lejuar nga shteti, për ta rrjepur shtetin dhe vetë njerëzit. Një drejtues i së majtës që ndan pasurinë kombëtare, si të ishte malli i tij nga Surreli, gjithçka mund të jetë, por me kombin dhe popullin që i ka rënë rasti e shansi të drejtojë, ka pak lidhje. Duke i detyruar 77 deputetë mjeranë, që janë lista e tij dhe që refuzimi do të thotë dërrmim, ta ngrenë dorën, ai krijoi një superfuqi, edhe mbi shtetin, ku nesër, kur të mos jetë kryeministër, ai mund të jetë bartësi i aksioneve të mëdha dhe kapoja i zotërimit të shtetit. Mungesa e Gjykatës Kushtetuese, që e shembi kur nuk duhej shembur dhe nuk po e ngre kur duhet ngritur, i jep gjithçkaje tablonë e një ngarendje pas vetes dhe në dëm të vendit.

Ende pa u ndërmarrë vendimi përfundimtar dhe kur vëmendja është përqendruar se çka thotë presidenti francez, njerëzit mësojnë se qeveria i ka dhënë një firme, gjysmamerikane, drejtuesi i së cilës është i njohur për lidhjet me zotin Meta dhe Berisha, koncesionin e Butrintit, perlës së njohur së arkeologjisë të kulturës shqiptare, e cila vetëm nga shitja e biletave përfiton deri në një milion euro në vit. Pastaj vjen lajmi tjetër, koncesioni për Kepin e Rodonit, po ashtu një zonë historike. Për 35 vjet. Do të thotë, përjetësisht. Askush në PS, në stafin e lartë drejtues të saj nuk thotë gjë. Pushteti qëndron mbi partinë dhe ia merr frymën së majtës. Deklarimet e Ballës ta marrin frymën edhe nga cektësia, ndërsa të Spiropalit të ngjallin të qeshurën. Ministrat dolën nga xhepi i majtë i shefit dhe iu servirën një plateje të heshtur që, si për të dashur të dëshmonte se kishte heshtur nga halli e frika, duartrokitën vetëm një zgjedhje, Erion Braçen. Po të varfrit që u shtuan, po klasa e mesme që po ikën, po të rinjtë e zhgënjyer? Në gjashtë vjet qeverisje nuk është dhënë thuajse asnjëherë rroga e trembëdhjetë, e shumëpritur nga nëpunësit dhe punëtorët, por u janë falur oligarkëve qindra milionë euro; u janë shtrënguar vidhat atyre që nuk kanë mundësi të paguajnë dhe asnjë subvencion nuk shkon drejt tyre, por tenderët dhe PPP-të vrastare kanë kosto të pamatë. Vetëm gjysma e këtyre abuzimeve nga PPP-të ishin të favor të njerëzve të zakonshëm, do të kishte edhe pagesa në muajin e pushimeve, që është harruar, edhe rrogë të 13-të, edhe shpërblimi i fundvitit për pensionistët, edhe libra, vërtet falas për fëmijët.

I nisur nga e majta, për të ndërtuar një shoqëri dhe shtet për njerëzit, po kthehet në një shoqëri edhe më tej të polarizuar dhe shtet të oligarkëve.

Kisha menduar me dëshirë të madhe se, sido kudo, nga një njeri i lexuar, që drejtoi bashkinë kryeqytetase me një dorë të hekurt dhe të frytshme gjërat do të ishin ndryshe, aq më shumë duke njohur kapacitetet intelektuale që ishin në të majtën.

Viti 2009 ishte fillimi i shkatërrimit të kësaj strukture, ndërsa viti 2013 i dha fund atij.

Të shohësh kur del për të folur një deputet a deputete dhe të mos e dish se kush është, edhe pas gjashtë viteve parlamentllëk, të mos dish se kush është ministre e kulturës, financës, se cili është roli i ministrit të jashtëm në detyrë, pse ministri i brendshëm, nga njeriu i thjeshtë i shkon shpesh herë delirantit, të të duket ministrja Besa e Arsimit më e mira dhe më e denja, duke e krahasuar me rreth e rrotull; të përpiqesh të gjesh se çfarë e pengon ministren e drejtësisë, që edhe pse bën një punë të mirë, nuk i çon gjërat deri në fund; të lodhesh për të ditur e nuk e di kurrë, përse Vetingu nuk filloi nga figurat e përfolura të sistemit të drejtësisë, të cilët dihej se kush ishin, duke lënë në punë disa struktura të jashtëzakonshme; përse, edhe pas kaq kohësh nuk ka asnjë nismë serioze për SPAK etj, të gjitha bashkë nuk janë asgjë ballë rolit të oligarkisë financiare dhe politike, të cilat, në tri vitet e fundit, janë bërë një palë që, që po tërheqin karron e vetvetes.

E majta do të kishte fituar në vitin 2013 edhe sikur lideri i saj të mos ishte Edi Rama, megjithëse paraqitja e saj ishte nën figurën e tij politike, që dukej vizionare, e kohës dhe e së ardhmes. Drejtimi i së majtës nga Rama solli më shumë vota, duhet saktësuar, por ndëshkimi ndaj qeverisjes Berisha, që ishte bërë sinonim i vjedhjes, vrasjes dhe shitjes, do të ndodhte.

Kam pasur rastin të kem në duar ose të njoh, qoftë edhe përmes mediave, të dhëna të ofruara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, institucioni më serioz dhe më i besuar i shtetit, edhe nga struktura të rëndësishme evropiane. Shifrat e paraqitura janë lebetitëse. Thuaj se çdo javë në 7 vitet e fundit, apo, mesatarisht çdo javë, është dërguar një dosje për ndjekje penale në sistemin e drejtësisë dhe është informuar struktura e lartë drejtuese e shtetit.

Edhe njerëzit e zakonshëm, e majta e lodhur nga keqqeverisja Berisha dhe zullumet e Lul Bashës, ka pritur ndëshkimin, që në fakt do të thotë mbyllja e së keqes.

Oratoria joshëse e Ramës, në dy fushatat për ndëshkimin e së keqes përfundoi duke e bërë të keqen pjesë të vetes dhe natyrshmëri politike.

PPP-ja e famshme për autostradën Milot - Balldre, ka një çmim të pamatë, dhe kjo sepse është e lidhur me oligarkë afër shefit të qeverisë. Me të njëjtën shumë të afruar nga qeveria, një firmë tjetër ndërtimi, me përvojë, afron ofertën e saj që, kjo autostradë, të shkojë deri në Hanin e Hotit, por askush nuk e dëgjon. Çuditërisht autostrada mbyllet në fillimin e rrugës Lezhë-Shkodër, duke e lënë përsëri njëkalimëshe, çka e penalizon gjithë lëvizjen drejt Veriut.

Politikanët e pandëshkuar, premtim politik dhe mendësi e së majtës, si një domosdoshmëri për të kthyer vëmendjen drejt njerëzve është harruar prej kohësh, krimi i 21 janarit është shpërblyer në të holla. Gërdeci është amnistuar. Ata që hapën greminën financiare të vitit 2013 dhe predikuan theqafjen e vendit, janë shpërblyer, thjeshtë nga lidhjet që kanë pasur me të njëjtët oligarkë që ka edhe shefi i qeverisë. Po, ata, të majtët, shpresëhumbur nga Berisha dhe tani bjerrahumbës nga Rama?

E majta në Shqipëri ka humbur liderin e saj dhe, si duket, nuk do të ketë forcë për ta rigjetur ose për ta rikthyer Ramën në mendimin politik dhe sjelljen politike të para vitit 2013, atëherë kur ua kishte nevojën atyre.

Fati i madh i tij është një opozitë laramane, pa vizion, pa ide, pa lider, që qahet edhe kur i ftohet supa dhe që doli në rrugë për të humbur gjithçka.

Por, nuk është fati i së majtës që në secilën ditë humb nga identiteti i saj dhe e sheh pa besim ringritje se si, pa pasur asnjë të keqe nga jashtë, krimbi i politikës po e bren nga brenda.

Rizgjimi do të jetë i vonshëm dhe me dhimbje.



## Rusia vendos trupat në kufirin sirian



Moskë, 23 tetor - Forcat ruse janë dislokuar në kufirin mes Turqisë dhe Sirisë si pjesë e marrëveshjes për largimin e trupave kurde. Njësitë e Moskës kanë hyrë tashmë në qytetet kufitare të Kobanes and Manbij-it. Sipas ujdisë, luftëtarëve kurdë u jepen 150 orë kohë duke nisur nga pasdītja e së mërkurës për t'u tërhequr në një largësi prej 30 km nga vija kufitare.
Forcat e Ankarasë do të vazhdojnë të kontrollojnë zonën që morën gjatë ofensivës kundër milicëve kurdë, që Turqia i konsideron terroristë. Pjesë e planit të saj është të krijojë një "zonë sigurie", në kufi, në të cilin të strehohen rreth 2 milionë refugjatë sirianë.
Marrëveshja u negociua pas bisedimesh të zgjatura mes presidentit turk Rexhep Taip Erdogan dhe homologut te tij rus, Vladimir Putin në resortën e Sochi-it. Sipas të dhënave të ShBA-së luftëtarët kurdë në Siri duhet të jenë tërhequr ndërkohë nga zona e sigurisë e planifikuar prej Ankarasë.
Kryekomandanti i milicëve YPG ka informuar zëvendëspresidentin e SHBA-së Mike Pence përmes një letre se njësitë e tij janë larguar nga territori në kufi me Turqinë. Rusia mbështet në konfliktin e Sirisë kreun Bashar al-Assad, por gjithashtu mban si ndërmjetës kontakte të ngushta edhe me Turqinë.
Luftëtarët dhe liderët politikë kurdë nuk kanë bërë asnjë koment, nëse do të pajtohen me marrëveshjen.

# Taylor: Trump i kërkoi Kievit një nder në këmbim të një tjetri

Gjatë dëshmisë së tij ambasadori në Ukrainë William B. Taylor Taylor përsëriti qëndrimin e tij se ishte diçka e çmendur që të kushtëzoje ndihmën e nevojshme ushtarake për Ukrainën me premtimin nga Kievi për t'i hetuar dyshimet për korrupsion ndaj ish-nënpresidentit Biden



AP

Uashington, 23 tetor - Zëvendës ndihmës Sekretarja e Mbrojtjes për Rusinë, Ukrainën dhe Euroazinë Laura Cooper mbërriti të mërkurën në Kongres për të dëshmuar mbi ndihmën ushtarake prej 250 milionë dollarësh për Ukrainën e cila u mbajt e ngrirë nga Shtëpia e Bardhë, me gjithë këmbënguljen e Pentagonit që ajo të lëvrohej.
Dëshmia vjen në kuadër të hetimeve që ligjvënësit po zhvillojnë rreth veprimeve të presidentit Donald Trump lidhur me Ukrainën, në një përpjekje për ta shkarkuar atë.
Të martën diplomati më i lartë amerikan në Ukrainë dëshmoi përpara Kongresit se i atij i ishte thënë se Shtëpia e Bardhë do ta zhbllokonte ndihmën ushtarake vetëm nëse Ukraina premtonte publikisht se do t'i hetonte demokratët, ish-nënpresidentin Joe Biden si dhe djalin e tij, ka njoftuar voa.
Dëshmia me dyer të mbyllura e ambasadorit amerikan në detyrë në Ukrainë William B. Taylor bie ndesh me pohimet e presidentit sipas të cilit nuk ka pasur "quid pro quo" me Ukrainën. "Quid pro quo" është një shprehje latine që nënkupton shkëmbimin e një favori me një tjetër favor. Por Shtëpia e Bardhë vazhdon ta mohojë një gjë të tillë.
"Sot kishte thjesht më shumë thashetheme dhe rrjedhje selektive informacioni nga seancat e fshehta e të motivuara politikisht të demokratëve. Kjo marrëzi vazhdon çdo ditë duke u harxhuar më shumë kohë e para taksapaguesve", tha zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë Stephanie Grisham në një deklaratë.
Gjatë dëshmisë së tij ambasadori Taylor përsëriti qëndrimin e tij se ishte diçka e "çmendur" që të kushtëzoje ndihmën e nevojshme ushtarake për Ukrainën me premtimin nga Kievi për t'i hetuar dyshimet për korrupsion ndaj ish-nënpresidentit Biden.
Në fjalën e tij të hapjes në seancën me dyer të mbyllura Taylor bëri të ditur se kishte zhvilluar një bisedë telefonike me ambasadorin e ShBA-së në Bashkimin Evropian Gordon Sondland, i cili dëshmoi javën e kaluar.
"Gjatë telefonatës, ambasadori Sondland më tha se presidenti Trump i kishte thënë se dëshironte që presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskiy të deklaronte publikisht se Ukraina do të hetojë Burisman dhe pretendimet për ndërhyrje të Ukrainës në zgjedhjet amerikane të vitit 2016", tha në dëshminë e tij Taylor.
Djali i Joe Bidenit, Hunter Biden, ishte anëtari i bordit të Burismas, një kompani gazi në Ukrainë. Sipas Trumpit, kur Bideni mbante detyrën e nënpresidentit, ai kishte kërcënuar se do ta ndalte ndihmën ndaj Ukrainës, nëse Kievi nuk ndalte një hetim për korrupsion ndaj Burismas.
Por Trumpi nuk ka ofruar asnjëherë ndonjë dëshmi për korrupsion nga Joe Bideni apo djalit të tij. Akuza se Ukraina ndërhyri në zgjedhjet presidenciale 2016-s për llogari të demokratëve bazohet në një teori konspirative.
Taylor tha se Sondland i kishte thënë atij se Trumpi donte që Zelenskiy "të bënte një deklaratë publike, duke urdhëruar nisjen e hetimeve".
Sipas Taylor, Sondland pranoi se bëri "gabim" kur u kishte thënë zyrtarëve ukrainas se nga premtimi publik i Zelenskiy për t'i nisur hetimet, varej vetëm takimi në Shtëpinë së Bardhë me Trumpin.
"Në fakt ambasadori Sondland tha se nga një njoftim i tillë, varej gjithçka, përfshirë ndihma për sigurinë", shtoi Taylor.
Sondland u kishte thënë më herët diplomatëve të tjerë se Trumpi këmbëngulі se nuk do kishte pasur një "quid pro quo" në raport me Ukrainën, por në fakt ai po përsëriste atë që Trump i kishte thënë atij.
Komisionet e Dhomës së Përfaqësuesve të udhëhequra nga Demokratët po zhvillojnë seanca dëgjimore me dyer të mbyllura për të përcaktuar nëse do të rekomandojnë ngritjen e akuzave zyrtare për shkarkimin e presidentit Trump, pjesërisht lidhur me dyshimet për përfshirjen e një vendi të huaj në zgjedhjet amerikane.
Ligjvënësja demokrate Debbie Wasserman Schultz e quajti dëshminë e Taylor "si më inkriminuesen që kishte dëgjuar".

## Turqia bisedon me Rusinë për blerje të reja të sistemit S-400



Turkish Defense Ministry (AP)

Ankara, 23 tetor - Turqia po diskuton blerjen e sistemeve të tjera S-400 nga Rusia, tha eksportuesi shtetëror i armëve ruse Rosoboronexport, pavarësisht paralajmërimeve të përsëritura të Uashingtonit kundër veprimeve të tilla.
Shefi i Rosoboronexport, Aleksandr Mikheyev, i tha agjencisë ruse të lajmeve Interfax se dy palët po diskutojnë për financimin dhe "kohën e dorëzimit" të sistemeve për mbrojtje raketore.
Ai nuk dha më shumë detaje.
Turqia, anëtare e NATO-s, ka marrë dërgesën e parë nga Rusia me S-400 në muajin korrik, duke bërë që ShBA-ja ta përjashtojë atë nga programi i saj i avionëve luftarakë F-35.
Raporti i ri vjen një ditë pasi presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, takoi presidentin e Rusisë, Vladimir Putin, në Soçi dhe tha se Rusia dhe Turqia do të vazhdojnë bashkëpunimin e tyre në mbrojtje.
"Puna me S-400 vazhdon. Turqia po merr prokurime të furnizimit. Bashkëpunimi dypalësh në industrinë e mbrojtjes do të vazhdojë me vendosmëri", tha Erdogani.
Gjatë takimit të njëjtë, Putin dhe Erdogan janë pajtuar që t'iu lejojnë forcave kurde të tërhiqen nga zonat pranë kufirit të Sirisë me Turqinë dhe që Turqia dhe Rusia të patrullojnë atje së bashku


Shijo
Pranverën
me...
Jaffa Champion PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa Champion


AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

E rrallë

## Stafit i bie të fikët në avion, pasagjerët kërkojnë ulje të menjëhershme



Një avion që po udhëtonte nga Britania për në Amerikë ka bërë një ulje të detyruar pasi dy prej stafit të linjës ajrore ranë pa ndjenja dhe shumë prej pasagjerëve filluan të ndiheshin keq. Sipas asaj që raporton "Daily Mail", shkaku i kësaj ngjarje ishte një solucion i përdorur për pastrim dhe desinfektim ishte derdhur në tualet e më pas në kabinë. Kjo ka shkaktuar skuqje të syve dhe kruajtje në lëkurë. Kapiteni i avionit kontaktoi me kontrollin e trafikut ajror duke u kërkuar një ulje emergjente dhe shërbim mjekësor.

FOTO E DITES



Një grua shihet duke ecur derisa fermerët protestojnë me traktorë kundër politikës bujqësore të qeverisë në Bon të Gjermanisë. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Ngordhin nga uria 55 elefantë



Të paktën 55 elefantë kanë ngordhur nga uria në Parkun Kombëtar të Zimbabve në Hwange gjatë dy muajve të fundit. "Situata është e rëndë. Elefantët po ngordhin nga uria dhe ky është një problem i madh", ka thënë zëdhënësi Tinashe Farawo. Thatësira ka ulur masivisht prodhimin e të korrave në Zimbabve. Një e treta e popullsisë raportohet se ka nevojë për ndihmë ushqimore në mes të një krize të vazhdueshme ekonomike.

## BARSOLETA E DITËS



**Bisedojnë dy policë**
**- Njeri, a ke dëgjuar që në Marks ka njerëz?**
**- Jo, ore!, - ia kthen tjetri. - E para, që ta dish, nuk thuhet Marks. Së dyti, se ka njerëz atje është vetëm hipotenuzë.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetem gjatë vikendit në ora 14:00**

### ABOMINABLE 3D



I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton

**Çdo ditë në ora 16:00**

### TOY STORY 4 / 3D



I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley

**Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00**

### MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D



Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning

**Çdo ditë në ora 22:00**

### ZOMBIELAND DOUBLE TAP



Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot do të keni sukses në një fushë kreative, e cila mund të lidhet me komunikimin në publik.



**DEMI**
Në fillim të ditës do të mësoni disa lajme të mira që lidhen me karrierën.



**BINJAKËT**
Disa festa ku duhet të merrni pjesë do t'ju bëjnë që ta kaloni kohën duke bërë blerje e biseduar me njerëzit.



**GAFORRJA**
Juve po ju 'pushtojnë' shkresat në lidhje me çështjet financiare. Mos harroni t'i paguani faturat!



**LUANI**
A keni menduar që të ndërtoni karrierë si një shkrimtar apo mësues? Nëse është kështu, sot është dita për të filluar.



**VIRGJËRESHA**
Të qenit pranë njerëzve është diçka që ju pëlqen.



**PESHORJA**
Një grup në të cilin jeni të përfshirë prej kohësh mund t'ju bëjë një lloj vlerësimi ku do ta merrni rolin e liderit.



**AKREPI**
Edhe juve nuk ju ndahet suksesi. Por, kini kujdes, qëndroni me këmbë në tokë.



**SHIGJETARI**
Fuqitë tuaja të pastra dhe mendimet e qarta do t'u bëjnë tepër përshtypje të tjerëve.



**BRICJAPI**
Një letër ose telefonatë do të sjellë ndryshime pozitive në situatën tuaj financiare.



**UJORI**
Një person që nuk e njihni mjaft mirë, mund t'ju bindë të merrni pjesë në një ngjarje dhe të flisni për një çështje.



**PESHQIT**
Sot do të keni aftësi të mëdha në të folur apo në të shkruar.

# Dua Lipa rikthehet në 'Instagram'



Dua Lipa është rikthyer në rrjetin social 'Instagram'. Këngëtarja shqiptare me famë ndërkombëtare ka disa ditë që është 'zhdukur' nga ky rrjet social, por është kthyer të martën me një postim mjaft seksi. Ajo ndau një video duke vallëzuar nën të cilën ka shkruar: "Ju mungova?" Dua nuk e ka zbuluar arsyen e kësaj zhdukjeje mirëpo, sipas raportimeve, gjithçka lidhet me projektet e reja.

# Candice me bikini një milion dollarë



Candice Swanepoel ka treguar trupin seksi në bikine leopard teksa ka lansuar koleksionin e të brendshmeve "Jam e obsesionuar". Candice Swanepoel tashmë ka një seri fotosh tepër të nxehta. Bukuroshja bionde me këmbë të gjata ka treguar belin e saj të hollë me rroba banje Tropi of C. Ylli, e cila kohët e fundit ka folur shumë edhe për Afrikën e Jugut, që është vendlindja e saj, ka pozuar me bikini dhe ka thënë se kjo linjë ka kushtuar një milion dollarë.



# Tenisti i njohur lidh kurorë pas 14 vjet lidhje

Pas 14 vjetësh lidhje, tenisti spanjoll Rafael Nadal ka lidhur kurorë me të fejuarën e tij historike Mery Perello në Sa Fortaleza një zonë luksoze që ndodhet në Pollença në pjesën verilindore të Mallorcas. Ceremonia u zhvillua në mënyrë private dhe super të blinduar. Madje të ftuarve iu kërkua që të mos sillnin telefonat celularë me vete. Në dasmë morën pjesë rreth 350 të ftuar, mes të cilëve ishin trajneri i Nadal, Carlos Moya dhe tenistët e tjerë miq të 33-vjeçarit. Nadali në ceremoninë e martesës së tij kishte veshur një kostum të krijuar nga stilisti italian Brunello Cucinelli, ndërsa Mery Perello ishte me një fustan tepër të thjeshtë të krijuar nga stilistja spanjolle Rosa Clara.

# Zbulohet emri i vajzës së Keira Knightleyt



Keira Knightley dhe burri i saj James Righton kanë zbuluar emrin e vajzës së porsalindur dhe është Delilah. Aktorja 34-vjeçare e konfirmoi emrin gjatë një interviste në "The Telegraph". Nëse nuk e dini, James dhe Keira janë prindër të Edie, katërvjeçar.



Autor: GAZMEND MORINA

VENDOSJA E DIÇKAJE NË NJË VEND
VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE
ERA E KËNDSHME
AKTORI AMERIKAN RICHARD (shqip.)
PËRCAKTIMI I NUMRIT RENDOR TË REGJISTRIT; REGJISTRIMI
ZANORE
PËRFUNDIMI TEORIK, QË NXIRRET NËPËRMJET PËRFUNDIMIT SHKENCOR
SHKOJ, ECI (bised.)
VLERË, DOBI (krah.)
EPOKA E RE
PRODUKT ZJARRI

QË PRANON SI TË VËRTETË VETËM ATË QË ËSHTË E DOBISHME
BASHKËT. PERSON QË KA PASION PATOLOGJIK VËNIEN E ZJARREVE

KLUB I YNI FUTBOLLI
SKUADRA SPORTIVE / I GJYMTUAR

ZBUTJA OSE DOBËSIMI I NJË LËKUNDJE A GODITJE
BISKOTË E GATUAR ME ARRA (sh.shq.)

BASHKËT.
KËNGËTARJA KËRÇELI / I ÇMPREH
EPOKË (shq.) / ADEM JASHARI

AKTORJA AMERIKANE FARROW
DY ZANORE / MA JEP
GRIMCA MË E IMËT E ÇDO ELEMENTI

ALBERTO TOMBA
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / BASHKËT.
JEMENI / REOMIR, IRIDIUM
MARC ANTHONY / MUZIKANTI KRASNIQI

QË BËHET SIPAS NJË NORME TË CAKTUAR; I .......
DRU MESDHETAR

EPOKA E RE
ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ BECKHAM
MODELJA JONË NË FOTO ÇUNMULAJ
SUPER MODELJA AMERIKANE CRAWFORD (shqip.)
PASIMI (Sport)
OKSIGJEN, NEON
ISMET PEJA / “N” pas dy “T”
GJASHTARE / PËRGËZIM
NËNË (krah.) / QYTET NË MAQEDONI

SUNDIMTAR ME PUSHTET ABSOLUT E TË PAKUFIZUAR
DY ZANORE
I PJEKURI; I MATURI / KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK
BASHKËT. PRAPAVEP-RUESE

LLOJ MINERALI QË PËRDORET PËR PLLAKA IZOLIMI
BURRA TË GUXIMSHËM / DERA E VOGËL E THURUR ME THUPRA
FUTBOLLISTI ULIKS .... / QË KA TË BËJË ME ILIRËT DHE ROMAKËT

AKTORI FRANCEZ CASSEL (shqip.)
INVA MULA / DY (turq.)
RITUAL / TEFIK OSMANI
ELIZABETH TAYLOR / SELEN

SHTET I MADH NË AZI
FUTBOLLISTI BAJRAMI (TWENTE)
VARGJET E PËRPUTHURA / SHAMATA
HUMBUR (ang. orgj.) / NOTË MUZIKORE
I ÇMENDUR

BURRË TRIM E BUJAR
I EPIKËS / PRAROJ
FUTBOLLISTI ARGJENTINAS PABLO ..... (BENFICA)
HISTORIANI ZVICERAN SCHMITT (shq.) / KRIMB I DRURIT

EPOKA E RE
GAZETARJA SHQIPTARE .... TARE
LLOJ SHEQERKE
LLOJ GAZI ME ERË TË KEQE E TË FORTË / VEGËL MUZIKORE (sh.shq.)
TOKA E BUKËS / REGJISORI QOSJA
OLIVER KAHN / DY BASHKË-TINGËLLORE

I TURPËROVA
AXHAMI / SMALTI
ZANORE / KOHË KUR NIS TË ZBARDHË DITA (sh.pashq.)
ILAÇ

KTHESË RRUGË OSE LUMI
I DËRGUAR SPECIAL / EMËR FEMRE MYSLIMANE
MJET PËR TË RRËSHQITUR MBI BORË / BASHKËT.

MBYS DIKË ME ARMË ZJARRI
KËNGËTARJA VALENTINA / KUDRET ISAI
NIS TË ZBARDHË DITA / ELIZA HOXHA
DY BASHKË-TINGËLLORE / SHKRONJA XVIII

“R” pas dy “A”
VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE / SILIC
ISMET MUNISHI / KRYEMURG
BREJTËSI I VOGËL / RYSHFET

EPOKA E RE
FEMRA E ZGJEDHUR / HARK, KTHESË
IRMA LIBOHOVA / TRUP GJEOMETRIK
BANJË ALLATURKA / NDËRTIM ME TË CILIN RRETHOJMË OBORRIN
VENEZIA, ROMA / KRAHINË NË SHQIPËRI

ROKERI AMERIKAN KRAVITZ (shqip.) / FORTESË
VEPËR E KRIMINELIT / RIFAT ISMAJLI
KUNDREJT MALLKIME / “RISANI”
TEFTA TASHKO

→
RETURN ON EQUITY / BASHKËT.
GODINA MBI UJË / BASHKËT.
SHKRONJË GREKE / AUSTRIA
TOTENHAM / ZANORE

AKTORJA HOLLIVUDIANE ZETA JONES (shqip.)
KLUB I YNI FUTBOLLI
PEZMATIM I VESHIT

# Lulja e Basanit e mrekullueshëm për shëndetin dhe gjithë organizmin

*Vetitë kuruese të lules së basanit, një bimë barishtore që në gjendje natyrale rritet kudo, janë të njohura në mbarë botën*



Përdorimi i gjerë i kësaj bime në mjekësinë popullore apo në produkte të ndryshme medicinale, i jep një rëndësi të veçantë kultivimit saj. Kjo si për përdoruesin ashtu edhe për prodhuesin, lidhur me aspektin ekonomik.
Është përdorur prej vitesh, veçanërisht e përzier me vajin e ullirit, si një balsam kurativ dhe rigjenerues. Përdoret në rastet e prerjeve, djegieve dhe plagëve të ndryshme por edhe si një çaj qetësues.
Përdorimi i lule basanit ende lidhet me mjekësinë popullore dhe kurat e kaluara brez pas brezi në mbarë botën.
Kërkimet e zhvilluara vitet e fundit tregojnë se lulja e basanit mund të ndihmojë në kurimin e formave të lehta dhe të mesme të depresionit.
Për më tepër këto kërkime shtojnë së kjo bimë ka efekte anësore më të pakta dhe më të lehta, në krahasim me mjekimet antidepresive.
Por lulja e basanit mund të bashkëveprojë me mjekime të caktuara që merren për të kuruar depresionin. Prandaj duhet që gjithmonë të merret nën mbikqyrjen e mjekut.
Kjo lule, e zier në formën e një çaji, mund të përdoret për probleme të lidhura me pagjumësinë, luhatjet e humorit, ankthin dhe depresionin.

### Vlerat mjekësore

Në shumë studime rezultatet e përdorimit të lules së basanit në trajtimin e depresionit tregojnë se kjo bimë ndikon po aq mirë sa antidepresivët për trajtimin e depresionit, por ka efekte anësore më të lehta.
Ekspertët e AgroWeb.org shpjegojnë se kjo bimë ka aftësi në rritjen e prodhimtarisë së lëndëve kimike që prodhon truri si serotonin, dopamine dhe norepinephrine.
Këto lëndë janë përgjegjëse në përmirësimin e humorit.

### Përzierja e vajit të ullirit me lulen e basanit - balsam që vjen ndër vite

Përzierja e vajit të ullirit me lulet e basanit, krijon një masë që në shumë kultura, në mbarë botën konsiderohet si një balsam magjik.
Në vendin tonë ky preparat përgatitet duke ndjekur këtë mënyrë.
Lulet e basanit hidhen në një shishe me vaj ulliri dhe kjo masë lihet në një ambient të errët për dyzetë ditë.
Pas kësaj kohe, kur farat e zeza të lules te kenë lëshuar pigmentin e tyre dhe vaji të ketë marrë ngjyrën e kuqe karakteristike, atëherë kjo përzierje mund të përdoret për të kuruar plagët e diegiet e jashtme.
Mund të konsumohet edhe duke pirë një lugë në ditë për të kuruar sëmundje të ndryshme të stomakut, mëlçisë, e më shumë.
Vaji përdoret edhe për kurimin e formave të ndryshme të gastritit.
Kultivimi i kësaj bime dhe përdorimi i saj në preparate të ndryshme të mjekësisë popullore përbën një fushë me interes për kërkimin shkencor dhe biznesin. */AgroWeb.org*

# Në vetëm 14 ditë - ujë me limon për rënien nga pesha



Shtyllat kryesore të misionit për rënien nga pesha janë: ushqyerja e shëndetshme dhe aktiviteti fizik.
Nëpërmjet tyre, rënia nga pesha është e shëndetshme dhe nuk shkakton dëme të forta në organizëm.
Limoni është një nga aleatët më të mirë të njeriut për rënien nga pesha.
Atë mund ta konsumoni çdo ditë, jo vetëm për të pastruar organizmin nga toksinat por edhe për të lehtësuar misionin e vështirë të humbjes së kilogramëve të tepërt.
Në këtë artikull të AgroWeb.org do të mësoni për sfidën 14 ditore të ujit me limon që ju ndihmon të humbisni në peshë në mënyrë të shëndetshme.
Nëse kërkoni rezultate më të shpejta rekomandohet të përdoret ujë i ngrohtë, duke qenë se eliminon më lehtë yndyrnat në trup.

### Ujë me limon për 14 ditë

Ju mund ta pini ujin me limon çdo ditë për dy javë duke iu përmbajtur rregullores së mëposhtme.

**Në ditën e parë,** përzieni lëngun e një limoni me një gotë ujë dhe pijeni menjëherë sapo të zgjoheni.
**Ditën e dytë** përzieni lëngun e dy limonëve me dy gota ujë. Shtoni një lugë çaji me mjaltë dhe pijeni pas zgjimit.
**Ditën e tretë** përzieni lëngun e tre limonëve me tre gota ujë. Shtoni një lugë çaji me mjaltë. Gjysmën pijeni në mëngjes dhe pjesën e mbetur para drekës.
**Ditën e katërt** shtrydhni katër limonë. Lëngun përziejeni me katër gota ujë dhe me një lugë çaji me mjaltë.
Lëngun ta pini tre herë në ditë, esëll në mëngjes, përpara drekës dhe para se të shtriheni për të fjetur.
**Ditën e pestë** përzieni lëngun e pesë limonëve me pesë gota me ujë dhe pak mjaltë dhe pijeni tre herë në ditë.
**Ditën e gjashtë** shtrydhni 6 limonë.
Lëngun përzieni me 6 gota me ujë dhe pak mjaltë dhe pijeni 3 herë në ditë përpara çdo vakti.
**Në ditën e shtatë** përzieni lëngun e 3 limonëve me 10 gota ujë.
Lëngun konsumojeni 3 herë në ditë përpara vakteve.
**Në ditën e tetë** përzieni lëngun e 6 limonëve me 6 gota ujë dhe pak mjaltë dhe konsumojeni tre herë në ditë.
**Në ditën e nëntë** përzieni lëngun e 5 limonëve me 5 gota me ujë dhe pak mjaltë.
Pijeni tre herë në ditë.
**Në ditën e dhjetë** përzieni lëngun e 4 limonëve me 4 gota me ujë dhe pak mjaltë. Lëngun pijeni 2-3 herë në ditë.
**Në ditën e njëmbëdhjetë** përzieni lëngun e 3 limonëve me 3 gota ujë dhe një lugë çaji me mjaltë.
Lëngun pijeni 2 herë në ditë.
Në ditën e 12-të shtrydhni dy limonë dhe lëngun përzijeni me dy gota ujë.
Lëngun pijeni esëll në mëngjes.
Në ditën e 13-të pini lëngun e një limoni të tretur në një gotë me ujë.
**Në ditën e katërmbëdhjetë** lëngun e tre limonëve përziejeni me 10 gota ujë.
Pijeni gjatë ditës dhe në këtë mënyrë keni përfunduar një sfidë shumë të shëndetshme.
Limoni do të përmirësojë tretjen dhe do ndryshojë prirjen tuaj të ushqyerjes duke e orientuar atë drejt ushqimeve më të shëndetshme.
Mund ta pini edhe paksa të ngrohtë në formë çaji, për ta pasur më të lehtë.

### Kujdes

Personat me tension të ulët duhet të tregojnë kujdes pasi uji me limon e ul më tepër tensionin.
Personat me probleme me aciditein e stomakut duhet të tregojnë kujdes ose ta hollojnë lëngun e limonit me më shumë ujë.
Ky regjim duhet kombinuar edhe me një ushqyerje të shëndetshme.
Pra nuk do të thotë që ta teproni me ushqime apo ëmbëlsira gjatë ditës.
Kujdes veçanërisht me darkën dhe të ecni gjatë ditës aq sa të mundni.
Me këtë regjim mund të humbisni deri në 8 apo 10 kg, nëse e ndiqni me përpikmëri. */AgroWeb.org*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Ditë e vendësve në Superligë

Skuadrat vendëse të mërkurën janë treguar dominuese ndaj skuadrave mysafire, pasi në tri ndeshjet e zhvilluara kanë dalë fitimtare. Gjilani, pas fitores ndaj Llapit, është ngritur në pozitën e parë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 TETOR - Gjilani, Drenica dhe Trepça '89 kanë realizuar fitore të mërkurën në përballje me Llapin, Dukagjinin dhe Ferizajn. Skuadra e Gjilanit, pas fitores së madhe në fundjavë ndaj Feronikelit, ka arritur edhe një tjetër fitore në derbin ndaj Llapit (3-0), e cila është e katërta radhazi për këtë klub. Në minutën e 41-të Tomislav Busiq e hapi serinë e golave për vendësit (1-0). Në pjesën e dytë gjilanasit e vazhduan dominimin dhe arritën të shënojnë edhe dy gola të tjerë. Për 2-0 është përkujdesur Bedri Greca, i cili ka realizuar në minutën e 72-të, kurse gjashtë minuta para fundit të ndeshjes Gerhard Progni e ka vulosur rezultatin final 3-0. Këto tri pikë e ngrehin Gjilanin në pozitën e parë të IPKO Superligës me 24 pikë, kurse Llapi renditet në vendin katërt me 20 pikë. "Federata e Futbollit e Kosovës duhet ta dijë që nuk janë vetëm dy klube në Superligë, Gjilani dhe Drita. Kështu siç po shkon kampionati, atëherë rrezikon të ndërpritet. Pjesa e parë ishte e barabartë, por në pjesën e dytë e humbëm paksa ritmin", ka thënë pas ndeshjes Tahir Batatina, trajner i Llapit.

Fitore me rezultat 3-0 shënoi edhe skuadra e Drenicës e cila e mposhti Dukagjinin e Klinës. Dy gola për kuqezinjtë nga Skenderaj i realizoi Harmon Van-Dave, kurse një tjetër e shtoi mesfushori Diar Mustafa. Drenica e Tahir Lushtakut renditet e shtata me 14 pikë, kurse skuadra e Dukagjinit është e parafundit me vetëm shtatë pikë. Në ndeshjen e tretë që u zhvillua në stadiumin "Riza Lushta" fituese doli skuadra e Trepçës '89 që me rezultat minimal e mposhti Ferizajn (1-0). Goli i vetëm në këtë ndeshje u shënua në pjesën e parë nga Leart Emini.

Të martën fitore kishte shënuar skuadra e Feronikelit në përballje me Vushtrrinë, kurse golin e fitores e shënoi Besmir Bojku në minutën e tretë shtesë.



**IPKO SUPERLIGA**

| | |
|---|---|
| Trepça '89 - Ferizaj | 1-0 |
| Gjilani - Llapi | 3-0 |
| Drenica - Dukagjini | 3-0 |
| Vushtrria - Feronikeli | 0-1 |

Të enjten takohen:
Ballkani - Flamurtari
Prishtina - Drita

**LIGA E PARË**

| | |
|---|---|
| Liria - Arbëria | 0-0 |
| Istogu - Vitia | 1-0 |
| Drenasi - Besa | 1-1 |
| Ramiz Sadiku - 2 Korriku | 2-1 |
| Vëllanzimi - Dardana | 1-1 |

Të enjten takohen:
Onix - Malisheva
Trepça - Vllaznia
Ulpiana - KEK-u

### Sot derbi Prishtina - Drita

Derbi i xhiros së njëmbëdhjetë në elitë zhvillohet sot (e enjte) në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 18:00. Prishtina e Armend Dallkut e pret Dritën me synim për t'i marrë pikët maksimale dhe për t'u rikthyer seriozisht në garë për pozitën e parë. Në anën tjetër, Drita është aktualisht e dyta, por me fitore do të rikthehet në krye të tabelës. Kjo ndeshje pritet të jetë jashtëzakonisht interesante, sepse interesimi për ta përcjellë është shumë i madh. Klubi kryeqytetas ka njoftuar se çmimi i biletave nuk ndryshon nga përballjet e tjera, sillet nga tri euro në tribunën lindore dhe tribunën veriore (për tifozët mysafirë), pesë euro në tribunën perëndimore dhe 10 euro në VIP. Ndërsa ndeshja në mes të Ballkanit dhe Flamurtarit zhvillohet sot nga ora 14:00.

# Dënohet Ismet Munishi

PRISHTINË, 23 TETOR (ER) - Komisioni Disiplinor i Federatës së Futbollit të Kosovës e ka dënuar trajnerin e skuadrës së Ballkanit, Ismet Munishi, me dy ndeshje ndalesë për kryerjen e detyrës zyrtare të trajnerit. Sipas KD-së, ky dënim ka ardhur për shkak se Munishi është ndëshkuar me karton të kuq në ndeshjen Drita - Ballkani, po ashtu ka pasur reagime të vazhdueshme në vendimet e gjyqtarëve dhe ofendime me akuza për korrupsion drejtuar gjyqtarit kryesor.



Nga skuadra e Ballkanit është dënuar me dy ndeshje moslojë edhe mbrojtësi Edmond Turku, i cili në ndeshjen ndaj Dritës është përjashtuar me karton të kuq. Komisioni Disiplinor e ka dënuar edhe skuadrën e Ferizajt me 1 500 euro për shkak të hedhjes së kanoçeve në fushë në dy raste si dhe përdorimit të pipit nga ana e spektatorëve në 4-5 raste në ndeshjen ndaj Prishtinës.

Ndërsa zyrtari i skuadrës së Llapit, Muhamed Rexhepi, është dënuar me dy ndeshje ndalesë për kryerjen e detyrës zyrtare në klub lidhur me ndeshjet e organizuara nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës. Rexhepi ka ofenduar gjyqtarët pas pjesës së parë të ndeshjes Llapi - Trepça '89. Me dy ndeshje moslojë është dënuar edhe futbollisti i Dukagjinit të Klinës, Ilir Syla.

# Prokuroria do t'i hetojë deklaratat se po kurdisen ndeshjet

PRISHTINË, 23 TETOR - Prokuroria e Shtetit nëpërmjet një komunikate për media bën të ditur se do ta fillojë hetimin e të gjitha deklaratave publike në lidhje me kurdisjen e ndeshjeve të futbollit.



"Prokurori i Shtetit njofton opinionin publik se është duke përcjellë të gjitha deklaratat e bëra publike lidhur me kurdisjet e ndeshjeve futbollistike si dhe ka kërkuar nga prokuroritë themelore që të fillohen hetimet për verifikimin e këtyre shkrimeve dhe paraqitjeve në media se ka kurdisje të ndeshjeve", thuhet në një komunikatë për media nga Prokuroria e Shtetit.

Ditët e fundit janë bërë akuza nga kryetari i klubit Ferronikeli, Naser Rama, ai i Llapit, Beqir Batatina dhe i FC Ballkanit, Arsim Kabashi, se klubet e tjera po blejnë gjyqtarë për t'i fituar ndeshjet duke dëmtuar klubet e tjera.

## Xhudistët kërkojnë sukseset e reja në 'Abu Dhabi 2019'

PRISHTINË, 23 TETOR - Grand Slami i Abu Dhabit të Emirateve të Bashkuara Arabe është stacioni i radhës në rrugën e gjatë drejt Lojërave Olimpike "Tokio 2020" për ekipin e xhudos së Kosovës, të cilët suksesshëm po e ndjekin normën olimpike. Majlinda Kelmendi (-52 kg), Nora Gjakova (-57 kg), Loriana Kuka (-78 kg) dhe Akil Gjakova (-73 kg) prej sot (e enjte) deri të shtunën do të synojnë ta fitojnë medaljen e radhës. Majlinda dhe Nora garojnë të enjten, kurse Akili garon të premten, ndërsa Loriana të shtunën.



## Toronto e nis me fitore sezonin e ri në NBA



Torino, 23 tetor - Ka nisur sezoni 2019-2020 i NBA-së teksa në fushë kanë zbritur disa nga ekipet pretendente për titullin kampion. Ekipi kampion i Torontos fitoi pas kohës shtesë 130-122 ndaj New Orleansit, ndeshje me rivalitet dhe emocione. Largimi i Leonardos u ndje shumë te ekipi kanadez, por dallimin në parket e bënë Siakam dhe VanVleet, që realizuan nga 34 pikë secili. Për miqtë u dallua Ingram me 22 pikë, por që mbetën për statistikë. Mjaft i bukur ishte edhe derbi i Los Anxhelosit, me Clippersi që mundi 112-102 Lakersin, ndeshje e vendosur në periodën e fundit. Lakersi e nisi më mirë ndeshjen, duke u shkëputur deri në 11 pikë falë 28 pikëve të Greenit dhe 25 të Davisit, por që mbetën për statistikë. Për Clippersin u dallua Leonardo, MVP i sezonit të fundit, që realizoi 30 pikë.

# Konjusha: Ditë e madhe për basketbollin e Kosovës

Prishtinë, 23 tetor - Mabetex Prishtina sonte (e enjte) do të përballet me Sparta & k M. R. Vidnoje, në grupet e FIBA EuroCup Women. Kjo do të jetë një ndeshje shumë e veçantë, pasi është hera e parë që vashat prishtinase luajnë në shtëpi në garat ndërkombëtare.
Para Mabetex Prishtinës ishte vetëm Universiteti që kishte garuar në Ligën Rajonale Trocal. Një nga basketbollistet më të dalluara të Prishtinës, Irma Konjusha, ka ftuar tifozët që t'i përkrahin maksimalisht. "Do të jetë një ndeshje e vështirë, pasi kemi të bëjmë me një ekip që ka shumë suksese në arenën ndërkombëtare. Jemi munduar të përgatitemi për këtë ndeshje dhe shpresoj që me ndihmën e tifozëve do të kemi një paraqitje shumë të mirë në parket", ka thënë Konjusha për faqen zyrtare të FBK-së.
Ajo ka folur edhe për rëndësinë



e kësaj ndeshje. "Është ndeshja e parë ndërkombëtare në shtëpinë tonë. Është një emocion i veçantë, pasi e kemi pritur këtë ditë një kohë të gjatë. Besoj në bashkëlojtaret e mia dhe në punën e trajnerëve dhe gjithçka mbetet të shihet në parket. I ftoj të gjithë që të na mbështesin për këtë ndeshje shumë të rëndësishme", ka deklaruar Konjusha.
Vashat e Prishtinës kanë nevojë më shumë se kurrë për përkrahje, pasi përballen me një kundërshtar shumë të fuqishëm dhe me përvojë në arenën ndërkombëtare. Ndeshja Mabetex Prishtina - Sparta&k M. R. Vidnoje zhvillohet të enjten nga ora 20:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Bardhekaltrat në ndeshjen e parë kishin pësuar nga MBA Moscow në udhëtim 90:58, derisa Sparta & k M. R. Vidnoje mundi Beshiktashin 80:71.

# Fituesja e medaljeve olimpike i jep fund jetës me 'euthanasia'

Bruksel, 23 tetor - Në moshën 40-vjeçare kampionia belge Marieke Vervoort i dha fund jetës së vet, duke aplikuar ligjin e "euthanasia". Dhimbja e shkaktuar nga sëmundja që i kishte paralizuar këmbët ishte bërë e padurueshme, ndaj katër herë fituesja e medaljeve olimpike në Lojërat Olimpike vendosi t'i japë fund jetës. "Tani për tani po shijoj ende jetën. Kur do të kem më shumë ditë të shëmtuara se të mira do të aplikoj ligjin e 'euthanasia', pasi dokumentet i kam gati", kishte deklaruar Vervoort pas medaljes së artë të fituar në Olimpiadën e Rios.
Praktimi i "Euthenasia" ("vrasje" me dëshirë e kërkuar nga vetë personi) është i lejuar në Belgjikë. Marieke Vervoort në moshën 14-vjeçare u diagnostikua me një sëmundje muskolare që i paralizoi këmbët. Por sëmundja është përkeqësuar shumë vitet e fundit, teksa nuk arrinte të flinte më. Ndaj ajo vendosi t'i thotë mjaft jetës. Ajo garonte me karrocën e saj në not, basketboll dhe triathlon.



Në Lojërat Olimpike "Londër 2012" ajo fitoi një të artë dhe një të argjendtë, ndërsa në "Rio 2016" fitoi një të argjendtë dhe një të bronztë. Në vitin 2008 Vervoort kishte firmosur me dëshirën e vet dokumentet për aplikimin e "euthanasia".

## SHKURT

### Schalke 04 dhe Leipzigu në garë për Rashicën

Ylli i Përfaqësueses së Kosovës dhe skuadrës së Werder Bremenit, Milot Rashica, është duke u kërkuar nga dy skuadra gjermane. Gazeta gjermane "Sport Bild", raporton se Schalke 04 dhe Leipzigu janë të interesuara për shërbimet e ish-lojtarit të Vushtrrisë. 23-vjeçari po kërkohet edhe nga skuadra e Milanit.

### 'El Clasico' zhvillohet më 18 dhjetor

Pas vendimit që ndeshja ndërmjet Barcelonës dhe Real Madridit të shtyhej, tani është caktuar një datë e re. 18 dhjetori është data kur do të luhet "El Clasico", raporton "Goal". Kjo ndeshje ishte shtyrë për shkak të protestave në Barcelonë gjatë dy javëve të fundit, derisa ishte menduar edhe opsioni që ndeshja të zhvillohej në "Santiago Bernabeu" e më pas të zhvillohej në "Camp Nou", por një gjë të tillë të dy klubet e kishin refuzuar. Por, tani klubet janë pajtuar që ndeshja të zhvillohet më 18 dhjetor në "Camp Nou".

### Jordani thumbon Curryn

Legjenda e NBA-së, Michael Jordan, ka deklaruar se Stephen Curry nuk është ende një lojtar aq i madh sa të hyjë në "Sallonin e Famës" (Hall of Fame). Në një intervistë për emisionin "Today", Jordan, me gjashtë tituj kampion në NBA, ka thënë: "Ai është një lojtar i madh, por ende nuk është një basketbollist që të meritojë të hyjë në Hall of Fame. Ende jo", ka thënë Jordan.
Kjo deklaratë ka befasuar të gjithë, por e thënë nga më i madhi i historisë së basketbollit nuk duket dhe aq. Stephen Curry ka fituar tre tituj kampionë në NBA me ekipin e Golden State si dhe dy herë ka "rrëmbyer" trofeun MVP. Ai ka një mesatare prej 23.5 pikësh për ndeshje në gjithë karrierën e tij. "Shpresoj që ai të mos mërzitet nga kjo deklaratë", ka shtuar Jordani.

### Mbappe e thyen rekordin e Messit

Sulmuesi i PSG-së, Kylian Mbappe, e ka thyer rekordin e yllit të Barcelonës, Lionel Messi. Francezi shënoi tre gola në fitoren e thellë ndaj Club Brugges, gjë që e shndërroi në lojtarin më të ri që shënon tre gola në Ligën e Kampionëve. Pasi u kthye nga regjimi për shkak të lëndimeve, 20-vjeçari hyri në ndeshje në minutën e 52-të dhe arriti të shënojë 3 gola. Ky rekord mbahej nga Lionel Messi, i cili kishte shënuar tre gola në Ligën e Kampionëve në moshën 21-vjeçare. Në vendin e tretë për këtë rekord mbetet legjenda e Realit, Raul, i cili e ka arritur këtë gjë në moshën 22-vjeçare.

### Motta, trajner i Genoas

Thiago Motta edhe zyrtarisht është trajneri i ri i Genoas. Ish-mesfushori i kuqebluve në sezonin 2008-2009 është emëruar pasues i Aurelio Andreazzolit i cili u largua për shkak të rezultateve të dobëta. Për Mottën kjo është përvoja e parë si trajner i një skuadre pasi më parë ka drejtuar të rinjtë e Paris Saint Germainit. Misioni i italo-brazilianit do të jetë ta nxjerrë Genoan nga kriza e rezultateve dhe ta largojë nga vendet e fundit të klasifikimit.

### Ferdinandi e ngre në qiell Sterlingun

Ish-mbrojtësi i Manchester Unitedit, Rio Ferdinand, beson se Raheem Sterling është ndër pesë lojtarët më të mirë në botë tani. 24-vjeçari shënoi tregolëshin e parë në Ligën e Kampionëve të martën në fitoren 5-1 të Manchester Cityt ndaj Atalantas. Ylli i Cityt gjithashtu ka shënuar edhe gjashtë gola në Ligën Premiere këtë sezon dhe Ferinandi beson se anglezi tani është ndër më të mirët në botë. "Ne po themi shumë fjalë të shkëlqyera për të", ka thënë fillimisht Ferdinand për "BT Sport". "Ai është një lojtar i ri anglez që ka luajtur shumë ndeshje. Ai ende është duke u përmirësuar dhe duke shtuar më shumë cilësi në lojën e tij. Ai është një nga pesë lojtarët kryesorë në botë tani. Pa dyshim! Efektin që ai ka, golat që shënon, është e pamundur ta mbani atë jashtë top-pesëshes", ka shtuar Ferdinandi.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
University Clinical Center of Kosovo
**Sektori i Personelit**

Nr.Ref. 1834/19, datë 22.10.2019.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, dhe Njoftimin nr. 2934 të datës 21.10.2019 për Sektorin Publik, përcjellë nga Shefi i Sektorit të Personelit në SHSKUK, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

## V E N D I M
**Për Anulim të Konkursëve të SHSKUK-së**

I.**Anulohen në tërësi** Konkurset sipas Kërkesës nr. 2934 të datës 21.10.2019 dhe Ligjit Nr. 06/L-114 – Për Zyrtar Publik, Anulohen këto konkurse:

1. Konkursi publik nr. 2318 datë 03.09.2019 për Spitalin e Përgjithshëm në Gjakovë për këto Pozita: 1.**Infermierë të Përgjithshëm –Bachelor** (tri pozita),2.**Infermierë të Përgjithshëm –SH.M** (dy pozita), 3.**Infermiere Akusherike –Mami-Bachelor**(një pozitë ), 4.**Teknik të Rentgenit-Bachelor** (një pozitë), 5.**Administrator në shërbimin e pranim-lëshimit** (një pozitë) dhe të gjitha procedurat e dala nga ky konkurs;
2. Konkursi publik nr. 2662/2 datë 24.09.2019 për një **Zyrtar/e Administrativ/e** dhe të gjitha procedurat e dala nga ky konkurs;

II.Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
III.Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Sektori i Personelit të SHSKUK-së më Kërkesën nr. 2934 datë 21.10.2019, kërkon që të zbatohet në tërësi Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarë Publik dhe kërkon Anulimin e të gjithë Konkurseve të cilët janë shpallur në të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK-së dhe janë në procedurë të përzgjedhjes duke filluar nga shpallja e konkursit deri tek para njoftimit përfundimtar për përzgjedhje, dhe të njejtën kohë t'i njoftojnë kandidatët për anulimin e konkursëve. Po ashtu, kërkojnë që asnjë konkurs të mos shpallet deri në një njoftim tjetër nga SHSKUK-ja.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe kërksës në fjalë, lejon anulimin e Konkursëve të lartëshënuar.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET
- ✓ Zyrës së personelit,
- ✓ Një mediumit informativ.
- ✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu

---

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*
*Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice*

AAPSK

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agencija za Upravljane Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

## Ftesë për ofertë në Ankand Publik
(Procedurë e përshpejtuar e shitjes)

**Datë 23.10.2019** **Referenca: AAPSK - 10/2019**

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

| Nr | Përshkrimi | Sasia/copë | Çmimi Fillestar/copë | Çmimi nga ofertuesi | Çmimi total € |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Dy Kuaj të bardhë; një kalë i zi dhe një mushkë e zezë | 4 copë | 160.00€ | | |

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf (urgjente) duhet të dorëzohen më së largu deri më 25.10.2019 në ora 12:00h, hapësirat e fermës ne Fsh. Kuklibeg KK. Dragash. Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 25.10.2019, prej orës 11:00-12:00 në hapësirat e fermës në fshatin Kuklibeg KK. Dragash.
Pasurit e sekuestruar/konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë.
Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se, në: https://md.rks-gov.net/. Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 10:00.
Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051 ose 044583030.

---

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
University Clinical Center of Kosovo
**Sektori i Personelit**

Nr.Ref. 1834/19, data 22.10.2019.

U skladu sa članom 13 Stav 3 Statuta Kosovske Bolnice i Službe za Kliničku bolnicu, i Obaveštenje br. 2934 od 21.10.2019. Za Javni Sektor, Prosleđen od strane Šefa Sektora za Kadrove u UBKSK, Generalni Direktor UBKSK-a izdao je sledeće:

## O D L U K A
**Za Otkazivanje Javni Konkursa za UBKSK**

I. Natjecanja se poništavaju u cijelosti prema Zahtjevu br. 2934 od 21.10.2019. I Zakon br. 06 / L-114 - za javne službenike, Otkazani su sledeći konkursi:

1. Javni konkurs br. 2318 od 03.09.2019 za Opštu bolnicu u Đakovici za sledeća radna mesta: 1. Opće medicinske sestre - prvostupnik (tri radna mesta), 2. Opće Medicinske sestre - MS (dve pozicije), 3. Pomoćnik za negu - prvostupnik (jedna pozicija), 4. Tehničar rendgenskih zraka -Bachelor (jedna pozicija), 5. Administrator u službi izdavanja (jedna pozicija) i sve procedure proistekle iz ovog konkursa;

2.Javni konkurs br. 2662/2 od 24.09.2019 za Administrativnog službenika i sve postupke proistekle iz ovog slobodnog mesta.
II. Sektor kadrova je obavezan da primeni ovu Odluku;
III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

**O b r a z l o ž e n j e**

Kadrovski Sektor UBKSK sa Zahtevom br. 2934, od 21.10.2019, Zahtieva da se Zakon br. 06 / L-114 o Javnim Službenicima i traži otkazivanje svih konkursa koji su raspisani u svim sastavnim jedinicama UBKSK i koji su u postupku izbora počevši od raspisivanja konkursa do konačnog obaveštenja o izboru i istovremeno obavestiti kandidate o otkazivanju konkursa. Takođe traže da se UBKSK do daljnjeg ne objavi konkurs do još jedne najave.

Skladom tome, Generalni Direktor UBKSK, na osnovu svoje nadležnosti, u skladu sa važećim zakonom i zahteva, omogućava otkazivanje gore navedenih ovog konkurs.

Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI
* Kancelarija za kadrove,
* Informacioni medij.
* Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu

---

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS
1970 MCMLXX

## NJOFTIM

Njoftohen të gjithë të interesuarit se, me datë **04.11.2019 duke filluar nga ora 10:30,** në Fakultetit Ekonomik të UP-së, në Sallën e Profesorëve, kandidati **Nexhat Kryeziu** i nënshtrohet mbrojtjes publike të punimit të Doktoraturës me titullë: "DISIPLINA FISKALE DHE KRIZA E BORXHEVE NË EUROZONË - MËSIMET PËR KOSOVËN".me mentor Prof.Dr. Valentin Toçi, dhe me Komisionin vlerësues me këtë përbërje:

Prof. Asoc. Dr. Driton Qehaja - Kryetar,
Prof. Asoc. Dr. Driton Balaj - Anëtar
Prof. Dr. Sherif Bundo - Anëtar i jashtëm

Shërbimi Doktoratë & Master Fakulteti Ekonomik UP

Dt.23.10.2019

**Kërkesa për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Nazmi Osmani"**
Komuna: **Kaçanik**
Data: **24.10.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| ESIP/SD/028-CS/1.8-2019 ESIP/SDG/028-CS/1,5-2018 | Trajnim; Kujdestari i mire |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **SHFMU "Nazmi Osmani" Elezaj, Kaçanik.**

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

**Trajnim; Kujdestari i mire**

**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e arsimit "kujdestari i mirë";

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës në fushen e arsimit kujdestari i mirë (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

**Procesi i seleksionimit:**

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesimit për shërbime konsulente në adresën: **SHFMU "Nazmi Osmani" Elezaj, Kaçanik,** më së largu deri më **01.11.2019.**

1. 4. Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
Personi kontaktues: Jeton Vogliqi
Telefoni: 044 649 261
E-maili: jeton.vogliqi@outlook.com

**Kërkesa për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Idriz Seferi" Bob**
Komuna: **Kaçanik**
Data: **24.10.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| ESIP/SDG/025-CS/1.3-1.4 | Trajnim: SIGURIA E CILESISE |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **"Idriz Seferi" Bob, Kaçanik.**

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

**Trajnim: Siguria e Cilësisë**

**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e sigurisë së cilësisë.;

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha siguria e cilesise (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

**Procesi i seleksionimit:**

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesimit për shërbime konsulente në adresën: SHFMU **"Idriz Seferi" Bob, Kaçanik** , më së largu deri më **01.11. 2019.**

1. 4. Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
Personikontaktues: FlorijeZeneli-Berisha
Telefoni: 044/656-419
E-maili: florijezeneli@gmail.com

**Kërkesa për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Kadri Zeka" Kaçanik**
Komuna: **Kaçanik**
Data: **24.10.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/SDG/027-CS/1.2-1,4** | **Trajnim: Zbatimi i TI në mësimdhënie** |

**Qeveria** e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **"Kadri Zeka" Dubravë Kaçanik.**

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

**Trajnim: Zbatimi i Teknologjisë Informative në mësimdhënie (World, Exel dhe Power Point dhe Përdorimi i Internetit).**

**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

**Procesi i seleksionimit:**

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesimit për shërbime konsulente në adresën: **SHFMU "Kadri Zeka" Dubravë, Kaçanik** më së largu deri më **01.11.2019.**

1. 4. Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Personi përgjegjës; Tefik Vishi**
**Telefoni kontaktues 044-227732 ose 044-281252**
**Adresa elektronike E-mail;tefik.vishi@hotmail.com ose ekrem-topalli@hotmail.com**

**Njoftim për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Jusuf Gërvalla" Biçecë**
Komuna: **Kaçanik**
Data: **24.10.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/SDG/026-CS/1.3-1.5** | Trajnim: Gjithëpërfshirja - PIA |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **SHFMU "Jusuf Gërvalla" Biçecë, Kaçanik.**

**1.Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:**
**Trajnim: Gjithëpërfshirja – PIA**

**2.Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve nqë mund të aplikojnë janë:**

**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e e Gjithëpërfshirjes.;

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e Gjithëpërfshirjes (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

**Procesi i seleksionimit:**

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesimit për shërbime konsulente në adresën: **SHFMU "Jusuf Gërvalla" Biçecë, Kaçanik.** , më së largu deri më **01.11. 2019.**

1. 4. Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Kemal Dullovi - Drejtor**
**Tel. 044/235-659**
**kemaldullovi60@gmail.com**

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova – University Clinical Center of Kosovo
**Sektori i Personelit**

Nr.Ref. 1834/19, datë 22.10.2019.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, nenit 13 pika 1 e Statutit të QKUK-së, dhe Njoftimin nr. 2934 të datës 21.10.2019 për Sektorin Publik, përcjellë nga Shefi i Sektorit të Personelit në SHSKUK, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

## V E N D I M
## Për Anulim të Konkursëve të QKUK-së

I. **Anulohen në tërësi** Konkurset sipas Kërkesës nr. 2934 të datës 21.10.2019 dhe Ligjit Nr. 06/L-114 – Për Zyrtar Publik: Anulohen këto konkurse:
1. Konkursi publik nr. 2556 datë 12.09.2019 për dy **Psikologë Klinik** në Klinikën e Psikiatrisë dhe të gjitha procedurat e dala nga ky konkurs;
2. Konkursi publik nr. 2718 datë 26.09.2019 për një **Mjek Specialist të Kardiokirurgjisë** dhe një **Mjek Specialist të Oftalmologjisë** dhe të gjitha procedurat e dala nga ky konkurs;
3. Konkursi publik nr. 2433 dt. 09.09.2019 për një **Asistentë të Drjetorit të SHPTA-së** dhe të gjitha procedurat e dala nga ky konkurs;
4. Konkursi publik nr. 2628 të datës 18.09.2019, për **një vozitës për kategori "C"** dhe **dy vozitës me kategori "B"** dhe të gjitha procedurat e dala nga ky konkurs;

II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;

III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Sektori i Personelit të SHSKUK-së më Kërkesën nr. 2934 datë 21.10.2019, kërkon që të zbatohet në tërësi Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarë Publik dhe kërkon Anulimin e të gjithë Konkurseve të cilët janë shpallur në të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK-së dhe janë në procedurë të përzgjedhjes duke filluar nga shpallja e konkursit deri tek para njoftimit përfundimtar për përzgjedhje, dhe të njejtën kohë t'i njoftojnë kandidatët për anulimin e konkursëve. Po ashtu, kërkojnë që asnjë konkurs të mos shpallet deri në një njoftim tjetër nga SHSKUK-ja.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe kërkesës në fajlë, lejon anulimin e Konkursëve të lartëshënuar.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET
- ✓ Zyrës së personelit,
- ✓ Një mediumit informativ.
- ✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu

# FTESË PËR OFERTM

Në bazë të UA nga MASHT, me nr. 02/2016 të nenit 11, Këshilli Drejtues i Shkollës më dt. 13.09.2019 merr vendim:

T'u bëjë ftesë agjensioneve turistike për të aplikuar me oferta për ekskursionin e maturantëve të SHMM"Dr.Ali Sokoli" në Prishtinë

Ekskursioni do të realizohet në Shqipëri nga dt. 03.11 - 07.11.2019 me katër buajtje-pansion i plotë ku do të marrin pjesë 9-klasë me kujdestarë dhe rreth 300 nxënës.

Për kushtet teknike të kërkuara sipas Udhëzimit Administrativ dhe kërkesat e parashtruara nga KDSh, dosjen mund t`a merrni në zyren e administratës së shkollës.

Aplikuesit duhet t'i plotësojnë kushtet sipas dosjes të cilën mund ta merrni në adminiustraten e shkollës nga ora 08- 16h.

Oferta mbetet e hapur 7 ditë nga dita e publikimit.

Ofertat dorzohen në DKA- në Prishtinë

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova – University Clinical Center of Kosovo
**Sektori i Personelit**

Nr.Ref. 1834/19, data 22.10.2019.

U skladu sa članom 13 stav 3 Statuta Kosovske bolnice i službe za kliničku bolnicu, članom 13 tačka 1 Statuta UKCK i Obaveštenje br. 2934 od 21.10.2019. Za Javni Sektor, Prosleđen od strane Šefa Sektora za Kadrove u UBKSK, Generalni Direktor UBKSK-a izdao je sledeće:

## O D L U K A
## Za Otkazivanje Javni Konkursa za UKCK

I. Otkazana u celosti ovi Konkursa u skladu sa Zahtevom br. 2934 od dana 21.10.2019. I Zakon br. 06/L-114 - za Javne Službenike: Otkazani su sledeći konkursi:
1. Javni konkurs br. 2556 od 12.09.2019, za dva Klinička Psihologa na Klinici za Psihijatriju i sve procedure proistekle iz ovog konkursa;
2. Javni konkurs br. 2718 od 26.09.2019, Specijalistu Kardiološke hirurgije i Specijalistu Oftalmologije i svim postupcima proisteklim iz ovog konkursa;
3. Javni konkurs br. 2433 dt. 09.09.2019, za Zamenik Direktora Zajedničke tehničke administrativne usluge i sve procedure proistekle iz ovog konkursa;
4. Javni konkurs br. 2628 od 18.09.2019, Za jednog Vozača kategorije „C" i dva Vozača kategorije „B" i sve postupke proistekle iz ovog konkursa;

II. Sektor kadrova je obavezan da primeni ovu Odluku;

III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

### O b r a z l o ž e n j e

Kadrovski Sektor UBKSK sa Zahtjevom br. 2934, od 21.10.2019, Zahtijeva da se Zakon br. 06 / L-114 o Javnim Službenicima i traži otkazivanje svih konkursa koji su raspisani u svim sastavnim jedinicama UBKSK i koji su u postupku izbora počevši od raspisivanja konkursa do konačne obaveštenja o izboru i istovremeno obavestiti kandidate o otkazivanju konkursa. Takođe traže da se UBKSK do daljnjeg ne objavi konkurs do još jedne najave.

Shodno tome, Generalni Direktor UBKSK, na osnovu svoje nadležnosti, u skladu sa važećim zakonom i zahteva, omogućava otkazivanje gore navedenih ovog konkursa.

Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI
* Kancelarija za kadrove,
* Informacioni medij.
* Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Edona Salihu shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit AAB Prishtinë.

► Zeqir Fetahi shpall të pavlefshme Dëftesën e kl. VI -IX. SHM. E ulët "Fehmi Rama" Likoc.

► Kërkoj shporet për nxehje qendrore me dru të përdorur, që mundet të ngrohe deri 1000 m2, numri kontaktues 044-608-626.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
0.5L